



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 101

Tiranë – E premte, 7 korrik 2023

## PËRMBAJTJA

|                                                             | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|-------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ligj nr. 44/2023,<br>datë 15.6.2023                         | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin<br>arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 10795                                                                                                                                                                                                         |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 98, datë 4.7.2023               | Për shpallje ligji..... 10800                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Ligj nr. 46/2023,<br>datë 22.6.2023                         | Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të<br>Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës<br>së përbashkët të kalimit kufitar Shën Nikolla–Pulaj, për qarkullimin<br>rrugor ndërkombëtar dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të<br>kontrollit kufitar..... 10801                                |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 99, datë 4.7.2023               | Për shpallje ligji..... 10811                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 397, datë 29.6.2023 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, të<br>Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të<br>studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, dhe mbështetjen financiare të<br>studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në<br>institucionet publike të Arsimit të Lartë”..... 10811 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 402, datë 5.7.2023  | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 711, datë 29.10.2014, të<br>Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për administrimin<br>dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së<br>Shqipërisë’”..... 10813                                                                                                                |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 403, datë 5.7.2023  | Për një shtesë në vendimin nr. 851, datë 29.12.2021, të Këshillit të<br>Ministrave, “Për miratimin e transfertës kapitale në llogari të Fondit<br>Shqiptar të Zhvillimit”..... 10814                                                                                                                                                                       |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 404, datë 5.7.2023  | Për një ndryshim në vendimin nr. 226, datë 21.3.2017, të Këshillit të<br>Ministrave, “Për financimin e kostos së menaxhimit të projekteve që<br>zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit”, të ndryshuar..... 10814                                                                                                                                         |

|                                                                                                                 |                                                                                                                                           |       |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr.405, datë 5.7.2023                                                       | Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Gjykatën Kushtetuese, për mbulimin e shpenzimeve kapitale.....                | 10815 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 406, datë 5.7.2023                                                      | Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e miratuar për vitin 2023, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Shërbimit Informativ të Shtetit..... | 10815 |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 12, datë 30.6.2023                                               | Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë.....                                                   | 10816 |
| Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 90, datë 27.6.2023 | Për miratimin e tarifave të shërbimeve që u ofrohen subjekteve publike nga shoqëria “Illyrian Guard” sh.a.....                            | 10842 |
|                                                                                                                 | Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Agim Lami.....                                                                               | 10847 |



**LIGJ**  
**Nr. 44/2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME**  
**NË LIGJIN NR. 69/2012, “PËR SISTEMIN**  
**ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË**  
**REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,**  
**TË NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

1. Pas pikës 5 të nenit 2 shtohen pikat 5/1, 5/2 dhe 5/3 me këtë përmbajtje:

“5/1. “Shkollë e bashkuar” është institucioni arsimor parauniversitar publik, që përfshin nxënës të disa niveleve arsimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

5/2. “Qendër Burimore” është institucioni arsimor parauniversitar, që ofron arsim special dhe shërbime të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara;

5/3. “Shkollë me status të veçantë” është institucioni arsimor parauniversitar publik, i arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv.

**Neni 2**

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Shkollat e arsimit të orientuar nisin në klasa të arsimit bazë, duke siguruar formimin e nevojshëm të nxënësve në lëndët e kulturës së përgjithshme. Në shkollat e arsimit bazë mund të

krijohen klasa të arsimit të orientuar, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.”.

2. Fjalja e parë dhe e dytë e pikës 4 ndryshohen si më poshtë:

“Arsimi bazë me kohë të plotë është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët me banim në Republikën e Shqipërisë nga mosha gjashtë deri në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj. Nxënësi ka të drejtë ta ndjekë arsimin bazë me kohë të plotë kur mbush moshën gjashtë vjeç edhe pas fillimit të vitit shkollor deri më 31 dhjetor të po atij viti kalendarik, deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç.”.

**Neni 3**

Pas pikës 4 të nenit 24 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Shkollë me status të veçantë është institucioni arsimor publik parauniversitar, me strukturë organizimi, kurrikul dhe mënyrë financimi të ndryshme nga institucionet arsimore publike parauniversitare. Kriteret e posaçme dhe procedurat për përfitim të këtij statusi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

**Neni 4**

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

**“Neni 24/1**

**Shkolla e bashkuar**

Shkolla e bashkuar është institucioni arsimor parauniversitar publik në të cilën përfshihen nxënës nga nivelet arsimore me kodet 1, 2, 3 ose vetëm disa prej tyre. Në këto shkolla mund të përfshihen edhe grupe të arsimit parashkollor. Mësimi në këto shkolla realizohet në një ose disa godina mësimore me vendndodhje të ndryshme.”.

**Neni 5**

Pas shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 28 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) planifikimin e nevojave për ndërtimin dhe rikonstruksionin e godinave të institucioneve

<sup>1</sup> Ky projektligj është përafëruar pjesërisht me Rekomandimin (2011/C 191/01) të Këshillit të Evropës, datë 28 qershor 2011 “Mbi politikën për të reduktuar braktisjen e parakohshme të shkollës”.



arsimore parauniversitare pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin për planifikimin dhe shpërndarjen e nxënësve në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.”.

Neni 6

Pika 1 e nenit 38 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 42 bëhen këto shtesa:

1. Në titull pas fjalëve “institucioneve arsimore private” shtohen fjalët “dhe institucioneve arsimore plotësuese private.”.

2. Në pikën 1 pas fjalëve “institucionet arsimore private” shtohen fjalët “dhe institucionet plotësuese private”.

3. Në pikën 2 pas fjalëve “institucioneve private” shtohen fjalët “dhe institucioneve plotësuese private”.

4. Në pikën 3 pas fjalëve “institucioneve arsimore private” shtohen fjalët “dhe institucioneve arsimore plotësuese private”.

5. Në pikën 7 pas fjalëve “institucioni arsimor privat” shtohen fjalët “dhe institucioni arsimor plotësues privat” dhe pas fjalëve “institucionit arsimor privat” shtohen fjalët “dhe institucionit arsimor plotësues privat”.

Neni 8

Neni 55 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 55

**Emërimi, ulja në detyrë, pezullimi dhe shkarkimi i drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar**

1. Drejtori i institucionit arsimor publik emërohet nga titullari i institucionit rajonal arsimor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar, pas propozimit të dy kandidatëve që vlerësohen me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit. Komisioni përbëhet nga një përfaqësues i njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore, një përfaqësues i institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, kryetari i bordit të institucionit, kryetari i këshillit të prindërve të institucionit dhe

dy mësues të institucionit arsimor, të zgjedhur nga këshilli i mësuesve. Njëri prej dy mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë institucion arsimor, drejton komisionin e vlerësimit.

2. Nëndrejtori i institucionit arsimor publik emërohet nga titullari i institucionit publik arsimor parauniversitar (IPAP) përkatës pas propozimit të dy kandidatëve, që vlerësohen me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit. Komisioni përbëhet nga kryetari i bordit të IPAP-së, kryetari i këshillit të prindërve të IPAP-së, dy mësues të IPAP-së, të zgjedhur nga këshilli i mësuesve, dhe një përfaqësues i ZVAP-së, i caktuar nga drejtori i institucionit vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, pas njoftimit zyrtar të drejtorit të IPAP-së. Njëri prej 2 (dy) mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë IPAP, drejton komisionin e vlerësimit.

3. Kandidati për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor duhet të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe të jetë i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar. Certifikimi i kandidatit për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor kryhet pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në shkollën e drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor. Në rastet kur asnjë nga kandidatët për drejtor ose nëndrejtor nuk është i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar, komisioni propozon dy kandidatë që vlerësohen sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Titullari i institucionit përkatës emëron një nga kandidatët për një periudhë 1-vjeçare, me kushtin që kandidati të jetë pranuar në shkollën e drejtorëve. Pas përfundimit të kësaj periudhe, rishpallet procedura për përzgjedhjen e drejtuesit të institucionit arsimor sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Drejtuesi i institucionit arsimor nuk mund të jetë anëtar i forumeve drejtuese të partive politike.

5. Titullari i institucionit rajonal arsimor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar, ul në detyrë, pezullon, shkarkon apo përfundon marrëdhëniet e punës për drejtorin e institucionit parauniversitar arsimor publik në rastet si më poshtë:

a) drejtori i IPAP-së ulet në detyrë në rast se pas vlerësimit vjetor të performancës nga ana e institucionit vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, rezulton me performancë jo të



kënaqshme. Ndaj tij merret masa disiplinore e uljes në detyrë nga titullari i institucionit rajonal përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe kalon në pozicionin e punës si mësues në profilin e tij brenda të njëjtut institucion arsimor ose në institucionin arsimor më të afërt, brenda të njëjtut institucion vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar.

b) për drejtorin e IPAP-së pezullohet marrëdhënia e punës dhe efektet financiare deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente në rastet kur:

i. gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal ndaj tij ose;

ii. është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të këtij ligji.

c) drejtori i IPAP-së shkarkohet në rastet si më poshtë:

i. ka një vendim të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të këtij ligji, apo të një vepre penale që dënohet me burgim;

ii. pas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për inspektimin, sigurimin e cilësisë, vlerësimin, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për parregullsi ose dobësi të theksuara në menaxhimin e IPAP-së;

iii. ka rast të përsëritur të shkeljeve për të cilat është ende në fuqi masa e vendosur nga Komisioni i Disiplinës “Paralajmërim për largim nga puna”;

iv. ka kryer shkelje të procedurave të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe/ose të Maturës Shtetërore;

v. ka organizuar ose ka lejuar gjatë procesit mësimor pjesëmarrjen e mësuesve apo të nxënësve në veprimtari partiake ose ka marrë pjesë në to;

vi. konstatohet se pas emërimit, drejtori i IPAP-së bën pjesë në forumet drejtuese të partive politike. Në këtë rast drejtori i institucionit vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar i kërkon zyrtarisht institucionit rajonal përgjegjës për arsimin parauniversitar shkarkimin e drejtorit të IPAP-së nga funksioni që kryen. Ky vendim merret jo më shumë se pesë ditë pas marrjes së kërkesës;

vii. IPAP-ja që ai drejton ka dy vlerësime të njëpasnjëshme “Dobët” nga institucioni vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar;

viii. kur ka kryer veprimtari në kundërshtim me aktet nënligjore të nxjerra nga ministri përgjegjës për arsimin parauniversitar.

ç) përfundimi i marrëdhënies së punës së drejtorit të IPAP-së bëhet në këto raste:

i. jep dorëheqjen;

ii. mbush moshën e pensionit;

iii. me vendim të komisionit mjekoligjor provohet paafësia për kryerjen e detyrave;

iv. merret masa disiplinore e largimit nga puna.

6. Titullari i institucionit arsimor përkatës ul në detyrë, pezullon, shkarkon apo përfundon marrëdhëniet e punës për nëndrejtorin e institucionit parauniversitar arsimor publik në rastet si më poshtë:

a) nëse pas vlerësimit vjetor të performancës nga drejtori i IPAP-së rezulton me performancë jo të kënaqshme. Ndaj tij merret masa disiplinore e uljes në detyrë nga titullari i IPAP-së dhe kalon në pozicionin e punës si mësues në profilin e tij brenda të njëjtut institucion arsimor ose në institucionin arsimor më të afërt brenda të njëjtut institucion vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar;

b) Për nëndrejtorin e IPAP-së pezullohen marrëdhëniet e punës dhe efektet financiare deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente në rastet kur:

i. gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal ndaj tij ose;

ii. është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të këtij ligji.

c) drejtori i IPAP-së shkarkon nëndrejtorin e IPAP-së kur:

i. ka një vendim të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të këtij ligji, apo të një vepre penale që dënohet me burgim;

ii. pas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për inspektimin, sigurimin e cilësisë, vlerësimin, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar, për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për parregullsi ose dobësi të theksuara në realizimin e detyrave të ngarkuara për menaxhimin e IPAP-së;

iii. ka rast të përsëritur të shkeljeve për të cilat është ende në fuqi masa e vendosur për “paralajmërim për largim nga puna”;



iv. konstatohet se pas emërimit, nëndrejtori i IPAP-së bën pjesë në forumet drejtuese të partive politike. Në këtë rast, drejtori i IPAP-së merr vendimin përfundimtar për shkarkimin e nëndrejtorit të IPAP-së jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas konstatimit;

v. ka kryer veprimtari në kundërshtim me aktet nënligjore të nxjerra nga ministri përgjegjës për arsimin.

ç) përfundimi i marrëdhënies së punës së nëndrejtorit të IPAP-së bëhet kur:

i. jep dorëheqjen;

ii. mbush moshën e pensionit;

iii. me vendim të komisionit mjekoligjor provohet paaftësia për kryerjen e detyrave;

iv. merret masa disiplinore e largimit nga puna nga drejtori i IPAP-së.

7. Masat e sipërcituara të dhëna ndaj drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit arsimor parauniversitar publik jepen në proporcion me shkeljen dhe bazohen në kriteret e mëposhtme:

a) shkallën e pakujdesisë;

b) shpeshhtësinë e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;

c) përvojën dhe pozicionin në sistemin arsimor;

ç) dëmtimin, mundësinë e shkakutimit të dëmtimit ose shkallën e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi.

8. Drejtori dhe nëndrejtori kanë të drejtë të dëgjohen nga titullari i institucionit përkatës para se të merret njëra prej masave të sipërcituara. Seanca dëgjimore dokumentohet me procesverbal.

9. Emërimi dhe/ose shkarkimi i drejtorit dhe nëndrejtorit në institucionin arsimor privat kryhet sipas procedurave të përcaktuara nga vetë institucioni në rregulloren e tij. Kriteret e kualifikimit, të përcaktuara për drejtorin dhe nëndrejtorin e institucionit arsimor publik janë të njëjta edhe për drejtorin dhe nëndrejtorin e institucionit arsimor privat.

10. Rregullat dhe procedurat për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit përcaktohen me udhëzim të ministrit.”

#### Neni 9

Në nenin 55/1 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 2 pas fjalës “mësues” shtohen fjalët “në arsimin parashkollor”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Në rastet kur asnjë nga kandidatët për drejtor nuk është i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar, komisioni propozon dy kandidatë që vlerësohen sipas pikës 1 të këtij neni. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse emëron një nga kandidatët për një periudhë 1-vjeçare, me kushtin që kandidati të jetë pranuar në Shkollën e Drejtorëve. Pas përfundimit të kësaj periudhe, rishpallet procedura për përzgjedhjen e drejtuesit të institucionit arsimor sipas pikës 1 të këtij neni.”

3. Në pikën 4, në fund të fjalisë së parë, shtohen fjalët “i cili konfirmohet nga institucioni përgjegjës për licencimin.”.

#### Neni 10

Pas pikës 5 të nenit 57 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Për nevoja të procesit mësimor, institucioni vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar emëron mësues në dispozicion, që plotësojnë kriteret e këtij neni.”.

#### Neni 11

Në nenin 60 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshon dhe bëhet “Pranimi, pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në institucionin arsimor publik, përfshirë edhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”, përveç mësuesit në dispozicion, i cili emërohet nga titullari i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, sipas renditjes në portal.”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Drejtori i IAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit në rastet kur:

a) gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal;

b) mësuesi është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të këtij ligji.”.



4. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë” përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

#### Neni 12

Pas nenit 60 shtohet neni 60/1 me këtë përmbajtje:

##### “Neni 60/1

#### **Ndalimi për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar**

Punonjësi arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët, nuk mund të punësohet dhe, kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës në rast se:

a) është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale; ose

b) është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.”.

c) veprat penale në kuptim të shkronjës “b” të këtij neni përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

#### Neni 13

Pas nenit 64 shtohet neni 64/1 me këtë përmbajtje:

##### “Neni 64/1

#### **Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në qendra burimore**

1. Qendër Burimore është institucioni i arsimit special, që ka për qëllim të mbështesë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar në vijmësi rezultatet e të nxënësve dhe t'i përgatisë ata për gjithëpërfshirjen dhe aftësimin për jetën, duke zhvilluar aftësitë e duhura në të gjitha fushat e

përditshmërisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë dhe mosdiskriminimin.

2. Me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin krijohen qendrat burimore si institucione arsimore parauniversitare, që ofrojnë arsim special dhe shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

3. Qendrat burimore kanë punonjës të specializuar në aftësinë e kufizuar, si mësues të arsimit special, mjekë, punonjës të shërbimit psikosocial, terapistë, që ofrojnë shërbime mbështetëse dhe rehabilituese të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara edhe në shkollat e zakonshme.

4. Qendrat burimore sigurojnë mbështetje për gjithëpërfshirjen në kuadër të burimeve që kanë në dispozicion, në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore parauniversitare, që arsimojnë nxënësit me aftësi të kufizuara.

5. Kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 14

Pika 2 e nenit 69 ndryshohet si më poshtë:

“2. Vendimi për dënimin e kundërvajtësit, sipas pikës 1 të këtij neni, është në kompetencën e institucionit përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor dhe merret në vend me konstatimin e shkeljes nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor sipas legjislacionit për inspektimin.”.

#### Neni 15

Në nenin 70 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në këtë nen fjalët “institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë ” zëvendësohen me fjalët “institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor”.

2. Në pikën 1 pas fjalëve “që konstatohet dhe dënohet nga” shtohen fjalët “inspektori i autorizuar nga”.



3. Në pikën 2 pas fjalëve “Kur është e nevojshme” shtohen fjalët “inspektori i autorizuar nga”.

4. Në pikën 3 pas fjalëve “për institucionin arsimor privat,” shtohen fjalët “nëse inspektori i autorizuar nga” dhe pas fjalëve “nëse është e nevojshme” shtohen fjalët “institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor”.

5. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3.1 Procedura që ndiqet nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, rregullohet nga legjislacioni për inspektimin.”.

#### Neni 16

Në nenin 71 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 të nenit 71 fjalët “institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar” zëvendësohen me fjalët “inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor, sipas legjislacionit për inspektimin”.

2. Në pikën 3 të nenit 71 fjalët “institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë” zëvendësohen me fjalët “institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor”.

#### Neni 17

##### Dispozita kalimtare

1. Kriteri i trajnimit dhe pajisjes me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor, si dhe drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor, sipas pikës 3 të nenit 55 dhe të pikës 2 të nenit 55/1 të ligjit, nuk zbatohet deri në 2 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për arsimin për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të nenit 60/1, shkronja “c”, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 17/1

Në nenin 73 të ligjit bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1 të nenit 73 pas numrit “2” shtohet numri “3” dhe pas numrit “12” shtohet numri “13”

2. Në pikën 2 të nenit 73 para numrit “7” shtohet numri “2” dhe para numrit “9” shtohet numri “8”.

#### Neni 18

##### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 15.6.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 98, datë 4.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj**

#### DEKRET

**Nr. 98, datë 4.7.2023**

##### PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

#### DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 44/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË**

**Bajram Begaj**





**LIGJ**  
**Nr. 46/2023**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË**  
**MALIT TË ZI PËR HAPJEN E PIKËS SË**  
**PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR**  
**SHËN NIKOLLA-PULAJ, PËR**  
**QARKULLIMIN RRUGOR**  
**NDËRKOMBËTAR DHE KRYERJEN**  
**E VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA**  
**TË KONTROLLIT KUFITAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Shën Nikolla–Pulaj, për qarkullimin rrugor ndërkombëtar dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 22.6.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 99, datë 4.7.2023, të**  
**Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bajram Begaj**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI “PËR**  
**HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË**  
**KALIMIT KUFITAR SHËN NIKOLLA-**  
**PULAJ, PËR QARKULLIMIN RRUGOR**  
**NDËRKOMBËTAR DHE KRYERJEN E**  
**VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA TË**  
**KONTROLLIT KUFITAR”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (në vijim të referuara si “Palët Nënshkruese”),

*duke u nisur nga* marrëdhëniet dhe bashkëpunimi miqësor dhe fqinjësor midis dy vendeve dhe në zbatim të nenit 14 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për bashkëpunimin policor ndërkufitar,

*duke pasur parasysh* mundësitë reale për fuqizimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit afatgjatë dhe reciprokisht të dobishëm dhe të barabartë ndërmjet dy vendeve, si dhe dëshirën e tyre për të krijuar kushte sa më të favorshme për zhvillimin e një bashkëpunimi të tillë,

*duke zbatuar* vendimet për përmirësimin e infrastrukturës rajonale dhe evropiane të transportit, si dhe legjislacionin dhe standardet e Bashkimit Evropian, rregullorja (BE) 2016/399 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 9 mars 2016, mbi Kodin e Bashkimit për rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufijve (Kodi për Kufijtë e Shengenit), në pjesën që u referohet kalimeve kufitare dhe kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror,

*me qëllim* thjeshtimin dhe lehtësimin e procedurave dhe masave të lidhura me kontrollet kufitare të menaxhimit të qarkullimit ndërkufitar ndërmjet dy vendeve,

*kanë rënë dakord* si në vijim:

**Neni 1**  
**Përkufizime**

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

1. “Pikë e Përbashkët e Kalimit Kufitar”, në vijim të referuar si “PPKK”, është pika kompetente e kalimit kufitar ku autoritetet kufitare të të dyja



Palëve kryejnë kontrolle kufitare dhe kontrolle doganore.

2. “Kontroll kufitar” nënkupton kontrollet e personave dhe dokumenteve të udhëtimit, mjetet e transportit dhe objekteve në pikat e kalimit kufitar gjatë orëve fikse të punës, në lidhje me kalimin e synuar të kufirit shtetëror ose menjëherë pasi të kalohet kufiri shtetëror, si dhe llojet e tjera të kontrolleve të personave, mallrave, shërbimeve, mjeteve të transportit, kafshëve dhe bimëve dhe produkteve të tyre që kalojnë kufirin shtetëror dhe parashikohen nga legjislacioni kombëtar i shteteve të Palëve.

3. “Kontroll doganor” nënkupton kontrollin e trafikut kufitar ndërmjet shteteve të Palëve që nënkupton zbatimin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të tjera të shteteve të Palëve, që zbatohen për kalimin e kufirit shtetëror nga udhëtarët, si dhe për importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave, kontrollin e mallrave, mjetet e transportit, bagazhet e pasagjerëve dhe mallrat e tjera që udhëtarët mbajnë ose kanë me vete, duke përfshirë edhe qarkullimin e sendeve me vlerë dhe instrumenteve fizike të pagesave të transferueshme.

4. “Shtet i hyrjes” nënkupton shtetin e Palës që kryen kontrollin doganor dhe kontrollet kufitare të hyrjes.

5. “Shtet i daljes” nënkupton shtetin e Palës që kryen kontrollin doganor dhe kontrollet kufitare të daljes.

6. “Zona e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar”, në vijim e referuar si “ZPPKK”, nënkupton zonën e caktuar, të siguar në përputhje me legjislacionin kombëtar të shteteve të Palëve, ku zyrtarët e të dyja Palëve janë të autorizuar të kryejnë kontrolle doganore dhe kontrolle kufitare, në përputhje me kompetencat e tyre.

7. “Personel/nëpunës” nënkupton personat që kryejnë detyra në fushat e kontrolleve doganore dhe kontrolleve kufitare, si dhe personat përgjegjës për monitorimin e shërbimeve të autorizuar nga secila Palë, si më poshtë:

a) për Republikën e Shqipërisë: punonjës të Policisë së Shtetit, të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, nëpunës të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë – Administrata Doganore dhe zyrtarë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;

b) për Republikën e Malit të Zi: punonjës të policisë së Ministrisë së Brendshme të Qeverisë së Malit të Zi – Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, nëpunës të Ministrisë së Financave të Qeverisë së Malit të Zi – Administrata Doganore, nëpunës të Ministrisë së Bujqësisë, Inspektorati Shtetëror për Bujqësinë, Inspektimi Fitosanitar, nëpunës të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

8. “Mallrat” nënkupton mallrat, mjetet e transportit dhe të mirat materiale që kontrollohen nga nëpunësit doganorë.

9. “Kontroll me një ndalesë” nënkupton kontrollin doganor dhe kontrollet kufitare të kryera nga nëpunësit e të dyja shteteve në një pikë të vetme, në të njëjtën kohë, ku përpunohen të gjitha procedurat.

10. “Shtet pritës” nënkupton Republikën e Shqipërisë, në territorin e së cilës autoritetet kompetente të shtetit fqinj kryejnë kontrolle doganore dhe kontrolle kufitare.

11. “Shtet fqinj” nënkupton Malin e Zi, autoritetet kompetente të të cilit kryejnë kontroll doganor dhe kontrolle kufitare në territorin e shtetit pritës.

Neni 2

### Objekti i Marrëveshjes

1. Objekti i kësaj Marrëveshjeje do të jetë hapja e Pikës së Përbashkët e Kalimit Pulaj/Shën Nikolla dhe kryerja e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar.

2. Pika e Përbashkët e Kalimit Kufitar do të jetë funksionale 24 orë në ditë për qarkullim ndërkombëtar të pasagjerëve.

Neni 3

### Vendndodhja e PPKK-së

Godina e Pikës së Përbashkët e Kalimit Kufitar do të ngrihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

### Ligji i zbatueshëm

1. Në lidhje me kontrollet doganore dhe kontrollet kufitare të kryera në PPKK, Palët Nënshkruese do të zbatojnë legjislacionin e tyre kombëtar. Shkelja e këtyre dispozitave në PPKK do të ketë të njëjtat pasoja juridike, sikur të kishin ndodhur në territorin e shtetit fqinj.



2. Detyrat zyrtare që do të kryejnë nëpunësit e shtetit fqinj në PPKK, do të realizohen në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës të shtetit fqinj dhe do të konsiderohet se janë kryer në territorin e atij shteti.

3. Kurdoherë që nëpunësit e secilës nga Palët ndërmarrin veprime, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, zyrtari i shtetit pritës do të informohet menjëherë dhe ai/ajo do të sigurojë mbështetje nëse është e nevojshme.

4. Legjislacioni kombëtar i vendit pritës që ka të bëjë me të huajt dhe azilin, nuk preket nga kjo Marrëveshje.

#### Neni 5

### Kontrollet kufitare dhe kontrolli doganor në hyrje-dalje

1. Shtetasit, automjetet dhe mallrat, të cilët hyjnë dhe/ose dalin nga territori i shteteve të Palëve, u nënshtrohen kontrolleve nga autoritetet përkatëse përgjegjëse, vetëm një herë, bazuar në parimin “një ndalesë një kontroll”, në hyrje dhe dalje njëri pas tjetrit, sipas legjislacionit kombëtar të secilit shtet të Palëve dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, në vendet e caktuara për këtë qëllim.

2. Pas nisjes së procedurës së verifikimit doganor dhe kontrolleve kufitare në hyrje, punonjësit/nëpunësit e shtetit të daljes nuk janë më të autorizuar të kryejnë veprime të lidhura me kalimin e kufirit. Megjithatë, nëse pas nisjes së procedurës së verifikimit doganor dhe kontrolleve kufitare në hyrje ka dyshime për vepra penale ose nëse konstatohet se një person i cili duhet arrestuar ndodhet në ZPPKK, nëpunësit e shtetit të daljes janë të autorizuar që të përsërisin procedurat e verifikimit kufitar, pasi të kenë njoftuar paraprakisht nëpunësit e shtetit të hyrjes.

3. Me pëlqimin e ndërsjellë, në rastet e rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme, dhe kur ka një rrezik për sigurinë publike, Palët mund të bien dakord të pezullojnë parimin e kontrollit me një ndalesë dhe të rivendosen kontrolle të rregullta.

4. Personat, të cilët refuzohen nga nëpunësit/punonjësit e shtetit të hyrjes, nuk mund të refuzohen të kthehen në shtetin e daljes/originës.

5. Mallrat, importi i të cilave është ndaluar nga nëpunësit e shtetit të hyrjes, do të lejohen të kthehen në shtetin e daljes.

6. Të ardhurat e mbledhura nga nëpunësit e shtetit fqinj në formën e tarifave zyrtare, për qëllime të procedurave të kalimit të kufirit në territorin e shtetit, i kthehen shtetit të tyre përkatës dhe nuk u nënshtrohen rregullave të eksportit. Të hollat dhe letrat me vlerë, të konfiskuara nga nëpunësit e secilës nga Palët gjatë kryerjes së kontrollit doganor, si dhe mallrat ose mjetet e sekuestruara trajtohen në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës dhe nuk u nënshtrohen rregullave të eksportit.

7. Gjatë zbatimit të masave të përmendura në paragrafët 4–6, nëpunësit e Palëve informojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën.

#### Neni 6

### Dokumenti i identitetit, uniformat dhe armët

1. Nëpunësit e shtetit fqinj, gjatë orarit të shërbimit, në ZPPKK do të mbajnë kartë identiteti zyrtare të shërbimit, që i jep nëpunësit të drejtën të hyjë në ZPPKK, të punojë në të dhe të kthehet në vendin fqinj. Megjithatë, kjo nuk ndalon autoritetet policore të vendit pritës që të refuzojnë hyrjen në ZPPKK për nëpunës të caktuar të vendit fqinj. Nëse një nëpunësi të vendit fqinj i është refuzuar hyrja në vendin pritës, autoritetet përkatëse do të informojnë pa vonesë autoritetet përkatëse të vendit fqinj mbi refuzimin.

2. Nëpunësit e të dyja Palëve, do të mbajnë uniformën e shërbimit gjatë kohës që ata janë të pranishëm në ZPPKK. Në rastet përjashtimore dhe kur bihet dakord nga autoritetet kompetente, nëpunësit mund të mbajnë veshje civile, me shenjën policia/doganat, të dukshme në anën e përparme dhe të prapme të veshjeve ose duke mbajtur dallueshëm kartat e identitetit.

3. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet që mund të ndodhin sipas paragrafit 2.

4. Nëpunësit e vendit fqinj do të mbajnë vetëm një armë të shkurtër shërbimi (armë brezi), nëse ata janë të autorizuar në këtë mënyrë nga legjislacioni kombëtar. Përveç kësaj, nëpunësit e policisë mund të mbajnë pranga, shkopinj gome dhe gaz lotsjellës, kur janë në detyrë në ZPPKK.



## Neni 7

**Përdorimi i forcës**

1. Forca, duke përfshirë forcën vdekjeprurëse, mund të përdoret vetëm në rastet e mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme në bazë të legjislacionit kombëtar.

2. Përdorimi i forcës duhet të jetë në përputhje me rrezikun dhe nuk duhet të tejkalojë kufijtë e nevojës për situatën konkrete.

3. Nëpunësit e Palës fqinje kanë të drejtë të përdorin forcën fizike për të izoluar personat që prishin rendin në ZPPKK.

4. Autoritetet e vendit pritës do të njoftohen për masa të paragrafit 3 të këtij neni pa vonesë dhe në rastet kur kërkohet, do të ofrojnë mbështetje.

## Neni 8

**Mbrojtja e nëpunësve**

1. Nëpunësit e të dyja Palëve Kontraktuese gëzojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje kur kryejnë detyrat e tyre në ZPPKK.

2. Gjykatat e shtetit fqinj kanë juridiksionin për të vendosur rreth kërkesave për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga punonjësit e këtij shteti, në lidhje me zbatimin e ligjit në ZPPKK. Këto pretendime gjykohen mbi bazën e ligjit të shtetit fqinj në fjalë.

3. Në rast shkelje disiplinore, nëpunësit iu nënshtrohen procedimit disiplinor sipas legjislacionit të secilës Palë.

## Neni 9

**Detyrimet dhe pretendimet**

Nëse një nëpunës i shtetit fqinj humb jetën ose plagoset në vendin pritës gjatë kryerjes së shërbimeve, nga ana e tij dhe/ose në lidhje me këtë shërbim, ose nëse pëson dëmtime fizike të shkaktuara nga një send/objekt që ai/ajo mban me vete, pretendimet kompensohen në përputhje me ligjin e shtetit fqinj.

## Neni 10

**Ambientet zyrtare**

1. Shtetit pritës, gjatë ndërtimit të godinës së PPKK-së, merr përsipër sigurimin e ambienteve të

nevojshme për nëpunësit e Palës fqinje, për ushtrimin e funksioneve zyrtare.

2. Ambientet zyrtare, të përdorura për kontrollin kufitar dhe doganor nga të dyja Palët, do të shënohen me shenja zyrtare dhe simbole shtetërore në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

## Neni 11

**Mirëmbajtja e ambienteve zyrtare**

Shpenzimet për mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta zyrtare të PPKK-ve, do të miratohen nga KPE-ja dhe do të ndahen në mënyrë të barabartë midis Palëve.

## Neni 12

**Telekomunikacioni dhe pajisjet e tjera**

1. Shteti pritës merr përsipër të miratojë instalimin e infrastrukturës telekomunikuese, të domosdoshme për të siguruar shërbimet e nevojshme të telekomunikacionit dhe informacionit.

2. Shteti pritës merr përsipër të mundësojë instalimin, zbatimin, komisionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve, pajisjeve dhe pajisjeve të telekomunikacionit dhe informacionit, duke përfshirë mbikëqyrjen me video dhe pajisjet e tjera elektronike të kërkuara vetëm për kontrollet doganore dhe kontrollet kufitare.

3. Funksionimi i sistemeve të telekomunikacionit dhe informacionit dhe përdorimi i frekuencave do të jetë në përputhje me rregulloret e secilës Palë.

4. Autoritetet kompetente të Palëve në ZPPKK do të përdorin frekuencën, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve.

5. Palët janë të detyruara të sigurojnë hapësirë të veçantë për ruajtjen e telekomunikacionit dhe sistemeve të informacionit siç kërkohet.

## Neni 13

**Pajisjet dhe objektet për përdorim zyrtar**

1. Objektet dhe pajisjet që janë për përdorim zyrtar në ZPPKK, nga nëpunësit e vendit fqinj, do të përdoren dhe transportohen pa detyrime doganore ose kufizime ose taksa të tjera. E njëjta gjë do të zbatohet për automjetet zyrtare dhe



private të përdorura nga nëpunësit gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

2. Pajisjet zyrtare të të dyja Palëve, të nevojshme për të kryer detyra në lidhje me verifikimin kufitar, në ZPPKK, mund të instalohen dhe të përdoren nga nëpunësit e tyre përkatës.

3. Qentë e shërbimit të të dyja Palëve kontraktuese do të konsiderohen si pajisje zyrtare dhe do të përdoren në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

4. Për çdo lloj ndryshimi që mund të ndodhë në lidhje me paragrafët 1 dhe 2, Palët Kontraktuese do ta informojnë njëra-tjetrën menjëherë nëpërmjet nëpunësve të tyre në ZPPKK.

5. Pala pritëse, përveç përjashtimit nga pagesa e detyrimeve, do të lejojë instalimin, zhvendosjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të telekomunikacionit që përdoren ekskluzivisht në veprimet e vendndodhjeve zyrtare të përcaktuara për kontrollin e kufirit nga nëpunësit e palës fqinje dhe do të lejojë edhe lidhjen e këtyre pajisjeve me pajisjet përkatëse të Palës fqinje. Përdorimi i pajisjeve të tilla do të konsiderohet si trafik i brendshëm i Palës fqinje.

6. Letrat, korrespondencat zyrtare, dokumentet dhe mjetet e tjera që përmbajnë të dhëna të përdorura nga nëpunësit e secilës Palë, kur kryejnë detyrat në ZPPKK, si dhe posta zyrtare dhe pajisjet zyrtare nuk do të kontrollohen apo sekuestrohen nga nëpunësit e Palës tjetër.

#### Neni 14

### Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve

1. Në mënyrë që të monitorohet zbatimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të ngrenë Komitetin e Përbashkët të Ekspertëve (në vijim “KPE”). Detyrat dhe punët e KPE-së do të rregullohen përmes rregullores së procedurave. Rregullorja e procedurave do të miratohet në mbledhjen e parë të KPE-së, e cila duhet të mbahet brenda 60 ditëve nga dita e fillimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të informohen përmes kanaleve diplomatike të caktimit të Kryetarit nga ana e tyre, të Komitetit të tyre të Përbashkët dhe kryetarët e komiteteve do të informohen për caktimin e anëtarëve të Komitetit të përbashkët dhe përfaqësuesit e tyre me shkëmbim notash.

2. KPE-ja do të përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues të përhershëm nga secila Palë, të cilët përfaqësojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

3. KPE-ja mbledhet rregullisht çdo gjashtë muaj. KPE-ja mund të mbledhet në çdo kohë, në rast kërkesë nga ndonjëra prej Palëve.

4. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, KPE-ja ka si detyrë të harmonizojë punën e autoriteteve kompetente në rregullimin e ambienteve, çështjeve teknike dhe të tjera, në lidhje me kalimet kufitare si më poshtë:

- monitoron dhe analizon frekuencën e qarkullimit të trafikut dhe propozon masa dhe aktivitete për qarkullim më të shpejte të njerëzve dhe mallrave;

- monitoron dhe analizon punën e shërbimeve kufitare kompetente dhe propozon masa për të përmirësuar funksionimin e kontrolleve të përbashkëta;

- kryen detyra të tjera që lidhen drejtpërdrejt me kontrollet e përbashkëta.

#### Neni 15

### Aktet zbatuese dhe shtojcat

1. Në përputhje me këtë Marrëveshje dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e KPE-së, Palët bien dakord të nënshkruajnë protokollet zbatuese të nevojshme ndërmjet institucioneve përkatëse.

2. Protokollet përcaktojnë aspektet e lidhura me funksionimin e PPKK-ve, si edhe vendin dhe mënyrën në të cilën do të kryhen kontrollet e përbashkëta.

#### Neni 16

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet e lidhura me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nga KPE-ja/autoritetet kompetente të secilës Palë.

2. Në rast se brenda tre muajve, KPE-ja nuk mund të gjejë zgjidhje të pranuar nga të dyja Palët, mosmarrëveshjet do të zgjidhen ndërmjet bisedimeve të ndërsjella nëpërmjet kanaleve diplomatike.



## Neni 17

**Dispozita e pezullimit**

Për arsye sigurie kombëtare apo për mbrojtjen e interesit publik, secila prej Palëve mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e Marrëveshjes apo të secilës prej dispozitave të saj në kushte të rrethanave që diktojnë një vendim të tillë në territorin e tyre. Pala tjetër njoftohet menjëherë me shkrim.

## Neni 18

**Dispozitat përfundimtare**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të së cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se procedurat e brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi kanë përfunduar.

2. Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund të zgjidhë këtë Marrëveshje në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja pushon së vepruari gjashtë muaj nga marrja e njoftimit nga Pala tjetër për zgjidhjen e saj.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të Palëve. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

4. Nënshkruar në Podgoricë, më 27.2.2023, në dy origjinale në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, të tria tekstet njëlloj të barasvlershme. Në rast të ndonjë mospërputhjeje lidhur me interpretimin, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**Për Këshillin e Ministrave  
të Republikës së Shqipërisë**  
Edi Rama  
KRYEMINISTËR

**Për Qeverinë e Malit  
të Zi**  
Dritan Abazović  
KRYEMINISTËR

**AGREEMENT**

**BETWEEN THE COUNCIL OF MINISTERS  
OF THE REPUBLIC OF ALBANIA AND THE  
GOVERNMENT OF MONTENEGRO ON  
THE OPENING OF THE JOINT BORDER  
CROSSING POINT SVETI NIKOLA - PULAJ  
FOR INTERNATIONAL ROAD PASSENGER  
TRAFFIC AND PERFORMING OF JOINT  
BORDER CONTROL**

The Council of Ministers of the Republic of Albania and The Government of Montenegro (hereinafter: the Signatory parties),

STARTING FROM the friendly and good-neighborly relations and cooperation between the two countries and the application of Article 14 of the Agreement between the Government of Montenegro and the Council of Ministers of the Republic of Albania on international police cooperation,

BEARING IN MIND the real possibilities for further strengthening and improvement of mutually beneficial and equal long-term cooperation between the two countries, as well as their desire to create the most favorable conditions for the development of such cooperation,

APPLYING the decisions on improving regional and European transport infrastructure, as well as legislation and standards of the European Union, Regulation (EU) 2016/399 of the European Parliament and of the Council of March 9, 2016 on the Union Code on the rules governing the movement of persons across borders (the Code on Schengen borders), in the part that refers to border crossing points and state border crossing control,

WISHING to simplify and facilitate the procedures and measures related to border control and management of international traffic between the two countries,

AGREED as follows:

## Article 1

**Definitions**

For the purposes of this Agreement:

1) "Joint border crossing point", hereinafter referred to as "JBCP", is a border crossing point where the border services of the Signatory parties perform border checks and customs control.



2) “Border control” is the checking of persons and travel documents, means of transport and facilities at the border crossing point during certain working hours, related to the intended crossing of the state border, i.e. immediately after crossing the state border, as well as other types of control of persons, goods, services, means of transport, which are transferred across national borders and are provided for by the national laws of the Signatory parties.

3) “Customs control” is the control of border traffic between the Signatory parties, which implies the application of all other laws and regulations of the Signatory parties, which are applied for crossing the state border of passengers, as well as for the import, export and transit of goods, control of cargo, means of transport, passenger luggage and other goods that passengers own or carry with them, including the circulation of valuables and physical transferable payment instruments.

4) “The country of entry” is the Signatory party that carries out customs and border control on entry.

5) “The country of exit” is the Signatory party that carries out customs and border control on the exit.

6) “Joint border crossing area”, hereinafter referred to as “JBCA”, is a certain area, secured in accordance with the national legislation of the Signatory parties, where officials of both parties are authorized to perform customs and border controls, in accordance with their competences.

7) “Personnel/Employees” are persons who perform duties in the areas of customs and border controls, as well as persons responsible for the supervision of authorized services from the Signatory parties, as follows:

a. For the Republic of Albania: officers of the State Police, Ministry of Internal Affairs of the Republic of Albania, officers of the Ministry of Finance of the Republic of Albania - Customs Administration and officers of the Ministry of Agriculture and Rural Development, National Food Control Authority;

b. For Montenegro: police officers of the Police Directorate of the Ministry of the Interior - Border Police Sector, officers of the Ministry of Finance - Revenue and Customs Administration and officers of the Directorate for Food Safety, Veterinary and Phytosanitary Affairs.

8) “Goods” are goods, means of transport and tangible goods controlled by customs officers.

9) “One-stop control” is customs control and border control performed by the officials of the Signatory parties in one place, at the same time, where all procedures are carried out.

10) “Host country” is the Republic of Albania, on whose territory the authorized services of neighboring countries perform customs and border control.

11) “The neighboring country” is Montenegro, whose authorized services perform customs and border controls on the territory of the host country.

## Article 2

### Subject of the Agreement

1. The subject of this Agreement is the opening of the Joint Border Crossing Point Sveti Nikola-Pulaj and the performance of joint border control operations.

2. The joint border crossing point shall function 24 hours a day for international passenger traffic.

## Article 3

### Location of the joint border crossing point

The location of the Joint Border Crossing Point is on the territory of the Republic of Albania.

## Article 4

### Applicable law

1. In connection with the customs and border controls that are carried out at the JBCP, the Signatory parties shall apply their national legislation. Violation of these provisions on the JBCP shall have the same legal consequences as if they had occurred on the territory of a neighboring country.

2. The official duties that shall be performed by the officials of the neighboring country at the JBCP shall be performed in accordance with the relevant national legislation of the neighboring country and shall be considered to have been performed on the territory of that country.

3. When the officials of any Signatory party take measures in accordance with paragraph 2 of this Article, the official of the host country shall be



notified immediately and shall provide support, if necessary.

4. The national legislation of the host country regarding foreigners and asylum shall not apply to this Agreement.

#### Article 5

##### **Border and customs controls at entry-exit**

1. Citizens, vehicles and goods, entering and/or leaving the territory of the Signatory parties, shall be subject to checks by the respective competent services, at the places designated for that purpose, only once, based on the principle of "one stop one control", at the entry and exit one after the other, according to the national laws of each Signatory party and in accordance with this Agreement.

2. After the initiation of customs control and border checks at the entrance, employees/officials of the country of exit shall no longer be authorized to carry out actions related to crossing the border. However, if after the initiation of the customs control and border check procedure at the entry there are doubts regarding criminal acts, or if it is established that the person who should be deprived of liberty is in the JBCA, the officials of the country of exit are authorized to repeat the border check procedures, after notifying the civil servants of the country of entry in advance.

3. With mutual agreement, in cases of unforeseen and extraordinary circumstances, when there is a risk to public safety, the Signatory parties may agree to abandon the principle of one stop - one control and undertake regular checks.

4. Persons who are denied entry by officials/employees of the country of entry cannot be prohibited from returning to the country of origin/exit.

5. Goods whose import has been prohibited by the officials of the country of entry shall be allowed to return to the country of exit.

6. Revenues collected from neighboring civil servants in the form of official fees, for the purposes of border crossing procedures on the territory of the state, are returned to their own state and are not subject to export regulations. Money and securities seized by officials of each Signatory party during customs control, as well as seized goods, shall be treated in accordance with the

national legislation of each Signatory party and are not subject to export rules.

7. During the implementation of the measures referred to in paragraphs 4-6, the Signatory parties shall inform and assist each other.

#### Article 6

##### **Identification documents, uniforms and weapons**

1. An employee in a neighboring country, during the working hours at the JBCA, shall carry an official identification, which gives the employee the right to enter the JBCA, to work and to return to the neighboring country. However, this does not prevent the police officers of the host country from refusing the entry to the JBCA to certain officers of the neighboring country. If a civil servant of a neighboring country is refused entry to the host country, the competent authorities shall notify the competent authorities of the neighboring country without delay about the refusal of entry.

2. Employed officials of the Signatory parties shall wear the official uniform while they are present at the JBCA. In exceptional cases and with the consent of the competent authorities, officers may wear civilian clothing, with police/customs insignia visible on the front and back of the clothing, or carry a visible official identification.

3. The Signatory parties shall notify each other of the changes that may occur in accordance with the previous paragraph 2.

4. Officials of the neighboring country shall carry only short official weapons, if they are authorized to do so by national legislation. In addition, police officers, while on duty at the JBCA, may carry handcuffs, rubber batons and tear gas spray.

#### Article 7

##### **Use of force**

1. The force, including firearms, may be used only in cases of necessary self-defense and extreme necessity, based on national legislation.

2. The use of force shall be in accordance with the danger and shall not exceed the limits necessary in the specific situation.





3. Officials of the neighboring country shall have the right to use physical force in order to isolate persons who disturb the order in the JBCA.

4. Authorized officials of the host country shall be notified of the measures from the paragraph 3 of this Article, without delay, and in cases where it is necessary, they shall provide support.

#### Article 8

##### **Employee protection**

1. Employees of the Signatory parties shall enjoy the same level of protection when performing their duties at the JBCA.

2. Claims for compensation for damage caused by employees in the host country, in terms of law enforcement at the JBCA, shall be the jurisdiction of the courts of the neighboring country. These requirements are evaluated based on the laws of the neighboring country.

3. In the event of a disciplinary violation, employees are subject to disciplinary proceedings in accordance with the law of the Signatory parties.

#### Article 9

##### **Liabilities and claims**

If an official of a neighboring country loses his life or is injured in the host country, during the performance of his official duties, or if he suffers a damage caused by the things/objects he is carrying, the related claims shall be compensated in accordance with the law of the neighboring country.

#### Article 10

##### **Official premises**

1. The host country, during the construction of the JBCP facility, shall assume the obligation to provide the premises necessary for the functioning of the officials of the neighboring country, for the performance of official duties.

2. The official premises used by the Signatory parties for border and customs control shall be marked with official marks and state symbols in accordance with the national legislation of the signatory parties.

#### Article 11

##### **Maintenance of official premises**

The costs of maintaining the joint official premises of the JBCP will be approved by the JEC and will be equally divided between the Signatory parties.

#### Article 12

##### **Telecommunications and other equipment**

1. The host country undertakes to approve the installation of the telecommunication infrastructure necessary for the provision of the necessary telecommunication and information services.

2. The host country undertakes to facilitate the installation, implementation, commissioning and maintenance of telecommunication and information systems, equipment and devices, including video surveillance and other electronic equipment required only for customs and border control.

3. The operation of telecommunication and information systems and the use of frequencies shall be in accordance with the regulations of the Signatory parties.

4. Competent authorities of the signatory parties at the JBCA will use the frequency, in accordance with the national legislation of the Signatory parties.

5. The Signatory parties are obliged to provide a special space for the storage of telecommunication and information systems as needed.

#### Article 13

##### **Equipment and facilities for official use**

1. Objects and equipment for official use at the JBCA, by the officials of the neighboring country, will be used and transported without customs or other restrictions or taxes. The same applies to official and private vehicles used by officials in the performance of their duties.

2. The official equipment of the Signatory parties, necessary for the performance of tasks related to the border control at the JBCA, may be installed and used by their officials.

3. Official dogs of both Signatory parties shall be considered official equipment and shall be used in accordance with paragraph 2 of this article.



4. For any type of change that may occur in connection with paragraphs 1 and 2, the Signatory parties will be notified in a timely manner, through their officials at the JBCA.

5. In addition to exemption from payment of obligations, the host country shall allow the installation, relocation, maintenance and use of telecommunications equipment, which is used exclusively for work in official premises designated for border control for the employees of the neighboring party. The connection of these devices with the corresponding devices of the neighboring party shall be enabled as well. The use of such devices shall be considered internal traffic of the Signatory party.

6. Letters, official correspondence, documents and other means containing the data used by the employees of the Signatory parties, during the performance of their duties at the JBCA, as well as official mail and official equipment shall not be checked or confiscated by officials of the other party.

#### Article 14

### Joint expert commission

1. In order to monitor the implementation of the provisions of this Agreement, the parties will establish a Joint Expert Commission (hereinafter JEC). The tasks and tasks of JEC are governed by the Rules of Procedure. The rules of procedure will be adopted at the first meeting of the JEC, which will be held within 60 days from the day of the start of the implementation of this Agreement. The parties will be informed about the appointment of their JEC presidents through diplomatic channels, through the exchange of notes about their expert commission, and the presidents of the commissions will be informed about the composition of the members of the joint commission and their representatives.

2. JEC will consist of 5 (five) permanent representatives of the Signatory parties.

3. JEC shall meet regularly every six months. JEC can meet at any time, in the event of a request from any of the Signatory parties.

4. For the purposes of this Agreement, JEC has the obligation to coordinate the work of the competent services for the arrangement of spatial, technical and other issues, in connection with the joint border crossing point, as follows:

- monitors and analyzes the frequency of traffic flows and proposes measures and activities for faster movement of people and goods;

- monitors and analyzes the work of competent border services and proposes measures to improve the work of joint controls;

- performs other tasks directly related to joint controls.

#### Article 15

### Executive acts and annexes

1. In accordance with this Agreement and taking into account the recommendations of JEC, the Signatory parties agree to sign the necessary protocols for the implementation of this Agreement between the relevant institutions.

2. The protocols shall define the scope related to the work of the JBCP, as well as the place and manner in which joint controls will be carried out.

#### Article 16

### Disputes

1. Any disputes related to the interpretation or application of this Agreement shall be resolved by JEC/competent authorities of the Signatory parties.

2. In the event that, within three months, the JEC cannot find a solution acceptable to the Signatory parties, the disputes will be resolved by mutual discussions through diplomatic channels.

#### Article 17

### Provisions on suspension

For reasons of national security or protection of public interest, each of the Signatory parties may temporarily suspend the implementation of the Agreement or any of its provisions, depending on the circumstances that require such a decision in their territory. The other Signatory party shall be notified immediately, in writing.

#### Article 18

### Final provisions

1. This Agreement shall enter into force on the day of receipt of the last written notification by which the Signatory parties inform each other,



through diplomatic channels, that the internal legal procedures have been completed.

2. This Agreement is signed for an indefinite period. Each Signatory party may suspend the application of the Agreement at any time, by written notification, through diplomatic channels. In such case, the Agreement shall cease to be valid six months after the receipt of notification from the other party.

3. This Agreement may be amended with the written consent of the Signatory parties. Amendments to this Agreement shall enter into force in accordance with paragraph 1 of this Article.

4. Signed in \_\_\_\_\_, on \_\_\_\_\_, in two original copies, in the, Albanian, Montenegrin and English languages, all texts being equally authentic.

In case of divergence in the interpretation of this Agreement the English text shall prevail.

**For the Council of Ministers of the Republic of Albania**

**For the Government of Montenegro**

**DEKRET**  
**Nr. 99, datë 4.7.2023**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 46/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Shën Nikolla–Pulaj për qarkullimin rrugor ndërkombëtar dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

**VENDIM**  
**Nr. 397, datë 29.6.2023**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 386, DATË 1.6.2022,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
MIRATIMIN E FUSHAVE DHE TË  
PROGRAMEVE TË STUDIMIT, QË  
PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR,  
DHE MBËSHTETJEN FINANCIARE TË  
STUDENTËVE TË SHKËLQYER E TË  
STUDENTËVE, QË NDJEKIN KËTO  
PROGRAME NË INSTITUCIONET  
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 2, fjalët “... për vitin akademik 2022–2023, e në vijim ...” hiqen.

b) Shkronja “c”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar.”.

c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Studenti përfitues sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, me qëllim vijimin e financimit, duhet të ruajë notën mesatare, jo më pak se 9.5 gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të ciklit të parë dhe të dytë ose gjatë ndjekjes së studimeve të integruara të ciklit të dytë në institucionin publik të arsimit të lartë.”.

ç) Fjalja e parë, e pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përzgjedhja e studentëve përfitues sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, kryhet në bazë të renditjes, sipas notës mesatare/vendit të renditjes në olimpiada ndërkombëtare dhe fondit në dispozicion për vitin përkatës financiar.”.



d) Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Përzgjedhja e studentëve përfitues për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, bëhet sipas kuotave të miratuara çdo vit për mbështetje financiare, për çdo IAL publike, nga ministri përgjegjës për arsimin dhe fondit në dispozicion për vitin përkatës financiar. Institucionet publike të arsimit të lartë i caktojnë këto kuota me vendim të Senatit Akademik për çdo program prioritar që ato ofrojnë, në përpjesëtim të drejtë me numrin e studentëve për çdo program dhe i përzgjedhin ato në bazë të renditjes, sipas notës mesatare në pranim, nëse numri i kërkuesve është më i madh se kuotat e ofruara. Vendimi i Senatit Akademik për shpërndarjen e kuotave për çdo program dhe për përzgjedhjen e studentëve

përfitues i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.”.

dh) Shtojca nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga viti akademik 2023–2024 e në vijim.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

#### SHTOJCA NR. 1

| Fushat e gjera të studimit                  | Fushat e detajuara të studimit         | Programi i studimit                                      |
|---------------------------------------------|----------------------------------------|----------------------------------------------------------|
| Arsimi                                      | Arsimi                                 | Arsim parashkollor                                       |
|                                             |                                        | Arsim fillor                                             |
| Arte dhe humanizëm                          | Gjuhë dhe letërsi                      | Gjuhë shqipe dhe letërsi                                 |
|                                             | Histori dhe arkeologji                 | Histori-Gjeografi                                        |
| Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë | Biologji                               | Biologji                                                 |
|                                             |                                        | Biologji-Kimi                                            |
|                                             | Biologji                               |                                                          |
|                                             | Shkencat e mjedisit                    | Studime mjedisore                                        |
|                                             |                                        | Shkenca mjedisore, profili: Menaxhim i burimeve natyrore |
|                                             | Shkencat e mjedisit                    |                                                          |
|                                             | Kimi                                   | Kimi                                                     |
|                                             | Fizikë                                 | Fizikë                                                   |
|                                             |                                        | Matematikë                                               |
| Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim             | Matematikë                             | Matematikë-Fizikë                                        |
|                                             | Matematikë-Elektronikë dhe automatizëm | Inxhinieri matematike                                    |
|                                             | Elektronikë dhe automatizëm            | Inxhinieri fizike _____                                  |
|                                             | Teknologjia e mbrojtjes së mjedisit    | Inxhinieri mjedisi                                       |
|                                             |                                        | Inxhinieri navale                                        |
|                                             | Mjete motorike, anije dhe avionë       | Navigacion dhe menaxhim detar                            |
|                                             | Mjete motorike, anije dhe avionë       | Inxhinieri e burimeve minerare                           |
|                                             | Miniera dhe industri nxjerrëse         | Inxhinieri e naftës dhe gazit                            |
|                                             |                                        | Inxhinieri gjeoinformatike                               |
|                                             |                                        | Inxhinieri gjeologjike                                   |
| Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar        |                                        | Inxhinieri geomjedis                                     |
|                                             |                                        | Inxhinieri agrare, profil: mbrojtje bimësh               |
|                                             |                                        | Inxhinieri agrare, profil: hortikulture                  |
|                                             |                                        | Inxhinieri agrare, profil: agronomi                      |
|                                             |                                        | Inxhinieri agrare, profil: agromekanizëm                 |
|                                             |                                        | Zootekni dhe siguria e produkteve blegtorale             |
|                                             |                                        | Biologji marine dhe akuakulturë                          |
|                                             |                                        | Bioteknologji zooveterinare                              |
|                                             |                                        | Agrobiologji                                             |
|                                             | Kultivim dhe prodhim                   |                                                          |
|                                             | Pyje                                   |                                                          |



|          |            |                                                                                 |
|----------|------------|---------------------------------------------------------------------------------|
|          |            | Agrobiznes                                                                      |
|          |            | Agroushqim                                                                      |
|          |            | Vreshtari-Enologji                                                              |
|          |            | Inxhinieri agronomike                                                           |
|          |            | Inxhinieri pyjore                                                               |
|          |            | Inxhinieri përpunim druri                                                       |
|          | Pyje       | Mjekësi veterinare                                                              |
|          | Veterinari | Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hotelieri-restorant, mikpritje) |
|          | Turizëm    | Ekonomi-Turizëm                                                                 |
| Shërbime |            | Turizëm                                                                         |

**VENDIM**  
**Nr. 402, datë 5.7.2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME**  
**NË VENDIMIN NR. 711, DATË 29.10.2014,**  
**TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR**  
**ADMINISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN**  
**E VARREZAVE NË TERRITORIN E**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 3/d, të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në rregulloren “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 711, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 21, të nenit 3, shtohet pika 22, me këtë përmbajtje:

“22. “Shtëpi funerale” është ambienti i padukshëm nga jashtë, i cili shërben si shtëpi pritjeje për kryerjen e ritualeve të lamtumirës dhe riteve të tjera në nderim të personave të vdekur.”.

2. Në nenin 36 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjalja e parë, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Agjencitë e shërbimit funeral licencohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, në drejtim të: ...”.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore parashikojnë kriteret dhe kushtet plotësuese që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, në lidhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore.”.

3. Në nenin 39 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Agjencitë dhe shtëpitë funerale duhet të zhvillojnë aktivitetin, si: plotësimi i formaliteteve, shitja e artikujve të varrimit dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me funeralin, brenda ambienteve të miratuara dhe që janë jo të dukshëm nga jashtë.”.

b) Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kontrollojnë agjencitë e shërbimit funeral dhe shtëpitë funerale për plotësimin dhe respektimin e kushteve e të kriterëve për ushtrimin e aktivitetit të tyre, të parashikuara në këtë vendim dhe në rregullat e vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, lidhur me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore.”.

**II. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të miratojnë kriteret dhe kushtet plotësuese që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për ushtrimin e aktivitetit në lidhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore.

2. Agjencitë, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të plotësojnë kriteret dhe kushtet për licencim, brenda 6 muajve nga miratimi i tyre nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.



3. Nëse pas afatit 6-mujor nga data e miratimit të rregullave të vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, agjencitë nuk i plotësojnë kriteret dhe kushtet e vendosura, ato nuk licencohen.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**VENDIM**  
**Nr. 403, datë 5.7.2023**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN**  
**NR. 851, DATË 29.12.2021, TË KËSHILLIT**  
**TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN**  
**E TRANSFERTËS KAPITALE NË**  
**LLOGARI TË FONDIT SHQIPTAR**  
**TË ZHVILLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

1.

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 851, datë 19.12.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Për të kryer veprime transferimi me fondin “Mjete në ruajtje” veprohet, si më poshtë vijon:

a) Destinacioni i përdorimit të fondeve, të përcaktuar në pikën 3, që janë “Mjete në ruajtje”, është për financimin e dy projekteve, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, konkretisht:

- Fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, i parashikuar për “Ndërhyrjen dhe përmirësimin e konektivitetit dhe rrugëve të aksesit”, në kuadër të programit buxhetor të 100

Fshatrave, për blerje makinerish që do të jenë pjesëmarrje në kapitalin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për mirëmbajtjen dhe hapjen e rrugëve rurale dhe turistike, në bashkëpunim me njësitë vendore;

- Fondi prej 600 000 000 (gjatëqind milionë) lekësh, i parashikuar për zhvillimin e modelit të integruar në formën e një parku multifunksional me temën e 100 Fshatrave në Valias në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës.

b) Fondet e përcaktuara në këtë vendim transferohen në llogarinë bankare të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

c) Transferimi i fondeve, nga “mjete në ruajtje” në llogarinë bankare të përcaktuar në shkronjën “b” më sipër, kryhet në përputhje me vlerën e kontratës së nënshkruar për secilin projekt.

ç) Diferenca e fondeve të papërdorura kthehet në buxhetin e shtetit.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**VENDIM**  
**Nr. 404, datë 5.7.2023**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN**  
**NR. 226, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT**  
**TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN**  
**E KOSTOS SË MENAXHIMIT TË**  
**PROJEKTEVE QË ZBATOHEN NGA**  
**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 50 e 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 6, pikat 2, shkronja “a”, e 4, dhe 8, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr.226, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... në masën 5%...” zëvendësohen me “.. në masën 7%...”.

2. Kostoja operationale në masën 7%, sipas pikës 1, të këtij vendimi, zbatohet për programet/projektet e reja të investimeve publike, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

## VENDIM

**Nr. 405, datë 5.7.2023**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2023, MIRATUAR  
PËR GJYKATËN KUSHTETUESE, PËR  
MBULIMIN E SHPENZIMEVE KAPITALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Gjykatës Kushtetuese, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale”, të programit buxhetor 03320 “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”, i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, për rikonstrukcionin e godinës së Gjykatës Kushtetuese.

2. Efektu financiar, prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2023.

3. Ngarkohen Gjykata Kushtetuese dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

## VENDIM

**Nr. 406, datë 5.7.2023**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË  
BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN  
2023, NDËRMJET MINISTRISË SË  
KULTURËS DHE SHËRBIMIT  
INFORMATIV TË SHETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023 bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Kulturës, në programin “Arti dhe kultura”, në shpenzime korrente, i shtohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh, për promovimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistiko-kulturore përgjatë sezonit turistik veror 2023.

b) Shërbimit Informativ të Shtetit, në programin “Veprimtaria informative shtetërore”, në shpenzime korrente, i pakësohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**



## UDHËZIM

Nr. 12, datë 30.6.2023

**PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE  
TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET  
E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

## UDHËZOJ:

## KREU I

**PORTALET E APLIKIMIT DHE TË  
REGJISTRIMIT**

1. Portali matura shtetërore *online* është sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të administrojë:

a) Procedurat e aplikimit me formularët A1 dhe A1Z të kandidatëve të maturës shtetërore, përfshirë kandidatët nga Kosova;

b) digjitalizimin e rezultateve të provimeve të maturës shtetërore;

c) prodhimin e diplomës së maturës shtetërore.

2. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (në vijim SMIP) është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë:

a) Procesin e regjistrimit dhe administrimit të rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë të kandidatëve, që kanë plotësuar formularin e aplikimit A1 ose A1Z në portalin matura shtetërore *online*;

b) ndërveprimin me portalin *U-Albania* nëpërmjet përcjelljes në RASH të bazës së plotë të të dhënave të kandidatëve, përfshirë kandidatët nga Kosova aplikues me formularët A1/A1Z;

c) prodhimin e certifikatës së maturës shtetërore.

3. Portali *U-Albania* është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë procedurat e mëposhtme:

a) Informimin e kandidatëve përfshirë ata nga Kosova për programet e studimit që ofrojnë IAL-të, për çdo vit akademik dhe për çdo program, në mënyrë të detajuar:

i. kriteret e pranimit;

ii. kuotat e pranimit;

iii. programet mësimore, kurrikulat etj.

b) Procesin e përzgjedhjes nga kandidatët të preferencave në programet e studimeve me karakter profesional, programet e studimit të ciklit të parë të studimeve dhe/ose programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, të shpallura nga IAL-të.

c) Përcjelljen IAL-ve të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve, përfshirë kandidatët nga Kosova që kanë përzgjedhur programet e studimit që këto IAL ofrojnë.

d) Procesin e shpalljes së listave renditëse të kandidateve në rang kombëtar, sipas renditjes dhe përlogaritjes së pikëve nga IAL-të.

e) Procesin e regjistrimit dhe të çregjistrimit të studentëve nga IAL-të për programet e studimeve me karakter profesional, për programet e ciklit të parë të studimeve dhe/ose programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, të shpallura nga IAL-të.

f) Sinkronizimin e regjistrimeve sipas çdo IAL-je në rang kombëtar dhe lëvizjen e vijës së kuqe në listën renditëse të kandidatëve.

g) Dhënien *online* të informacioneve të nevojshme për kandidatët, për ndjekjen në mënyrë dinamike, përgjatë raundit të parë dhe raundit të dytë, të procesit të shpalljes së fituesve.

4. Aplikimi i kandidatëve, përfshirë ata nga Kosova, me formularët A1 dhe A1Z, bëhet në portalin e maturës shtetërore *online*: [www.matura.qsha.gov.al](http://www.matura.qsha.gov.al), për programet e studimeve me karakter profesional, për programet e ciklit të parë të studimeve, për programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve dhe programet e dyta të studimit që nuk janë të të njëjtit cikël studimi në institucionet e arsimit të lartë.

5. Hedhja e rezultateve lëndore të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, për maturantët/kandidatët që kanë plotësuar *online* formularin A1 ose A1Z, bëhet nga drejtoritë e institucioneve arsimore në sistemin SMIP, ndërsa për kandidatët nga Republika e Kosovës hedhja e rezultateve bëhet nga institucioni arsimor parauniversitar, i përcaktuar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, pas njohjes dhe njehsimit të diplomës dhe rezultateve nga QSHA-ja.

6. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1 dhe A1Z, drejtoritë e institucioneve arsimore përkatëse, të caktuar nga





Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, nga ku ata kanë kryer aplikimin, hedhin në sistemin SMIP të dhënat e lidhura me rezultatet e njehsuara të shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.

7. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në vitet e mëparshme dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hedhin në sistemin SMIP të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.

8. Përzgjedhja e programeve të studimeve me karakter profesional, të ciklit të parë të studimeve, si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, të ofruara nga IAL-të për vitin akademik përkatës, bëhet në portalin e aplikimit universitar *U-Albania* <https://ualbania.al/>.

9. Regjistrimi i kandidatëve fitues të shpallur nga IAL-të kryhet nga sekretaritë mësimore dhe pasqyrohet në portalin e aplikimit universitar *U-Albania*: <https://ualbania.al/>.

10. MAS i përcjell zyrtarisht QSHA-së dhe RASH-it listën e programeve të studimit me karakter profesional, programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe numrin e kuotave të pranimi për secilin program studimi.

## KREU II

### PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË

#### A. PROCEDURAT E APLIKIMIT, RAUNDI I PARË

1. Kandidatët, përfshirë kandidatët nga Kosova (në vijim kandidatët) për ndjekjen e studimeve në IAL, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit *online* në portalin e aplikimit universitar *U-Albania*.

2. Aplikimi kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm të lartë;

b) plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) plotësojnë kriteret shitesë të përcaktuara nga IAL-të për programet e studimit për të cilat aplikojnë;

d) nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. Përfshirë, kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, me notë mesatare sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, aplikojnë në programet e studimit të ciklit të parë, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë, master në fushën e mësuesisë, duke konfirmuar në rubrikat e aplikimit dakordësinë për mosndjekjen e këtyre programeve në ciklin e dytë dhe pajisen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore me numër të veçantë matrikullimi, i cili nuk i lejon të ndjekin më pas, programet e ciklit të dytë, master në fushën e mësuesisë.

4. Kandidatët, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të cilën e shkarkojnë në portalin *U-Albania*. Periudha e kryerjes së pagesës dhe afati i dorëzimit të mandatit të pagesës, si dhe konfirmimi në portalin *U-Albania* nga sekretaritë e shkollave, përcaktohen në kalendarin e miratuar me urdher të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik (në vijim kalendar).

5. Sipas kalendarit, kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit, do të aplikojnë në portalin *U-Albania* nëpërmjet formularit *online* të aplikimit, mbi bazën e notës mesatare, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga IAL-të.

6. Kandidatët zgjedhin deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit, që ofrohen nga IAL-të, për vitin akademik përkatës.



7. Drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (në vijim DRAP/ZVAP) duhet të marrin masa për krijimin e kushteve për t'iu ofruar kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar, lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

**B. PËRCJELLJA E TË DHËNAVE DHE REZULTATEVE, PROCESI I PËRLLOGARITJES SË PIKËVE DHE PUBLIKIMI I LISTAVE TË KANDIDATËVE, RAUNDI I PARË.**

1. Sipas kalendarit, QSHA-ja i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e maturantëve/kandidatëve që kanë aplikuar me formularët A1/A1Z me të dhënat, si më poshtë:

- ID-n e maturës;
- të dhënat personale dhe të dhëna shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP, llojin e formularit);
- indekset e llojeve të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë.

2. Sipas kalendarit, QSHA-ja i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo kandidat të dhënat sa më poshtë:

- ID-n e maturës;
- të dhënat personale dhe të dhënat shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP/llojin e formularit);
- notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
- rezultatet e provimeve të maturës shtetërore;
- mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
- mesataren e provimeve të maturës shtetërore;
- mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;
- indekset e llojeve të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë.

3. IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi shkarkojnë, sipas kalendarit, nga portali *U-Albania* listën e kandidatëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.

4. Në datën e përcaktuar në kalendar, IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse, listat e kandidatëve. Konkursset e pranimit do të zhvillohen në periudhën e përcaktuar në kalendar.

5. Në datën e përcaktuar në kalendar, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali *U-Albania*, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a) listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;

b) notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;

c) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore;

d) mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;

e) mesataren e provimeve të maturës shtetërore;

f) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;

g) indekset e llojeve të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë.

6. IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përllogaritjes së pikëve për çdo kandidat, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara me vendim të Senatit Akademik, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishojnë në mjediset publike, si dhe në faqet e tyre zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe në listë, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

7. Brenda datës së përcaktuar në kalendar, IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së kandidatëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-n e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës së përcaktuar në kalendar, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin *U-Albania*.

**C. PROCESI I REGJISTRIMIT, RAUNDI I PARË**

1. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha e regjistrimit është e ndarë në 7 (shtatë) faza 48-orëshe, sipas afateve të përcaktuara në kalendar. Kandidati ndjek në portalin *U-Albania* ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në një apo disa programe studimi, nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kandidati i shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e



regjistrimit, në atë program studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

4. Për ndjekjen e ecures së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 (shtatë) fazave 48-orëshe MAS-i dhe RASH-i publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al) dhe <https://ualbania.al/>.

5. Procesi i regjistrimeve nga sekretariatë mësimore, me dokumentacion dhe *online*, vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të pranimit në programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të parë.

6. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe në listë dhe shpallen fitues të rinj, të cilët regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën e përcaktuar në kalendar. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara, të cilat nuk kanë kandidatë në pritje, do të rikthehen kandidatët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi kryhet sipas listës së renditjes së kandidatit për raundin e parë.

7. Brenda datës të përcaktuar në kalendar, RASH-i përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara, në format shkresor dhe elektronik, me informacionet si më poshtë:

- a) IAL-n;
- b) njësinë kryesore të IAL-së;
- c) ciklin e studimit;
- d) programin e studimit;
- e) datën e regjistrimit;
- f) ID-n e maturës;
- g) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

8. Kandidatët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t'u regjistruar në këtë raund, por kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit të dytë.

#### D. PROCESI I ÇREGJISTRIMIT, RAUNDI I PARË

1. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistrin e IAL-së, ka të drejtë të çregjistrohet në datat e përcaktuara në kalendar. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit

ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda këtij afati, ai nuk ka të drejtë të çregjistrohet, me qëllim regjistrimin në një program tjetër studimi ku është shpallur fitues për atë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin *U-Albania* nga sekretaria mësimore e fakultetit.

2. Sekretaritë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të kandidatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin *U-Albania* listën e kandidatëve të çregjistruar në format elektronik, sipas përcaktimeve në kalendar.

#### E. PROCESI I ANKIMIT, RAUNDI I PARË

1. Kandidati ka të drejtën e ankimit në IAL-të përkatëse në datën e përcaktuar në kalendar. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesës, IAL duhet të shprehet me vendim lidhur me ankimin.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyrojnë në format elektronik, në portalin *U-Albania*, brenda datës së përcaktuar në kalendar, vendimet lidhur me ankimet e kandidatëve.

3. Kandidati, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse është shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, vijon procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa është pranuar, ai duhet të çregjistrohet nga programi i studimit (nëse është regjistruar) dhe të regjistrohet në datat e përcaktuara në kalendar në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimi.

4. Kuotat e paplotësuara, në përfundim të raundit të parë për çdo program studimi, mund të përshtaten nga IAL-ja në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël, të ofruara brenda së njëjtës njësi kryesore, pa kaluar totalin e kuotave për njësi kryesore. IAL-ja njofton zyrtarisht MAS-in për vendimin e Senatit Akademik mbi përshtatjen e kuotave të programeve të studimit, jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga data e përfundimit të afatit për çregjistrim për raundin e parë. Në rast se përshtatja e kuotave është sipas përcaktimeve ligjore, MAS-i njofton IAL-në, RASH-in dhe QSHA-në, për konfirmimin e përshtatjes së kuotave para fillimit të periudhës së aplikimit për raundin e dytë.

#### F. PROCEDURAT E APLIKIMIT, RAUNDI I DYTË

1. Në periudhën e caktuar në kalendar, kryhet procesi i aplikimit *online* për raundin e dytë në portalin *U-Albania*. Kanë të drejtë të aplikojnë,



duke përzgjedhur deri në 10 (*dhjetë*) programe studimi, kandidatët, përfshirë edhe kandidatët nga Kosova, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e maturës shtetërore, por që:

- a) nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë;
- b) kanë kryer procesin e aplikimit *online* në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues;
- c) kanë kryer procesin e aplikimit *online* në raundin e parë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen;
- d) janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë.

2. Drejtoritë e institucioneve të arsimit të mesëm të lartë, për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar me formularin A1 dhe A1Z, hedhin në sistemin SMIP të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, deri në datën e përcaktuar në kalendar.

3. DRAP/ZVAP-të të marrin masa për krijimin e kushteve për t'iu ofruar kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar, lidhur me procesin e aplikimit për praninë në IAL.

4. Kandidatët, që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin *U-Albania*. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë, nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për këtë raund. Periudha e kryerjes së pagesës, afati i dorëzimit të mandatit të pagesës, si dhe konfirmimi në portalin *U-Albania* nga sekretaritë e shkollave, përcaktohen në kalendar.

5. IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përllogaritjes së pikëve për çdo kandidat, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja, me vendim të Senatit Akademik, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishojnë listat e renditjes në mjediset publike dhe i publikojnë në faqen zyrtare. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe në listë, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

6. Brenda datës së përcaktuar në kalendar, IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e

renditjes së kandidatëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-n e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës së përcaktuar në kalendar, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin *U-Albania*.

#### G. PËRCJELLJA E TË DHËNAVE DHE REZULTATEVE, PROCESI I PËRLLOGARITJES SË PIKËVE DHE PUBLIKIMI I LISTAVE TË KANDIDATËVE, RAUNDI I DYTË

1. Sipas afatit të përcaktuar në kalendar QSHA-ja i përcjell RASH-it, në formë shkresore dhe elektronike, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, si më poshtë:

- a) ID-n e maturës;
- b) të dhënat personale dhe të dhënat shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP, lloji i formularit);
- c) notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
- d) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore;
- e) mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
- f) mesataren e provimeve të maturës shtetërore;
- g) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;
- h) indeksat e llojeve të institucioneve arsimore parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë.

2. Në datën e përcaktuar në kalendar IAL-të shkarkojnë nga portalin *U-Albania*, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, si më poshtë:

- a) listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
- b) numrin personal të kandidatit;
- c) notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
- d) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore;
- e) mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
- f) mesataren e provimeve të maturës shtetërore;
- g) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;
- h) indeksat e llojeve të institucioneve arsimore parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë.

3. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, kryejnë procesin e përllogaritjes së pikëve për çdo kandidat, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara



nga IAL-të me vendim të Senatit Akademik. IAL-të për çdo program studimi që ofron, publikon listat e kandidatëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përlogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe në listë, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

4. Brenda datave të përcaktuara në kalendar, IAL-ja afishon dhe publikon listat e renditjes së kandidatëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-n e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ngarkon një kopje elektronike të këtyre listave në portalin *U-Albania*.

#### H. PROCESI I REGJISTRIMIT, RAUNDI I DYTË

1. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha e regjistrimit është e ndarë në 5 (pesë) *faza 48-orëshe*, sipas afateve të përcaktuara në kalendar. Secili kandidat ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në një apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kandidati i shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit në atë program studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

4. Nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit, gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të dytë, për programet e studimit, për të cilat nuk përcaktohen kritere shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare dhe numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara.

5. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 5 (pesë) fazave 48-orëshe, MAS-i dhe RASH-i publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al) dhe në portalin *U-Albania*: <https://ualbania.al/>

6. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe *online* vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listën e raundit të

dytë. Në rast se, pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj, të cilët regjistrohen në fazën pasardhëse. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë kandidatë në pritje, rikthehen kandidatët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi kryhet sipas listës së renditjes së kandidatëve për raundin e dytë.

7. Sipas afatit të përcaktuar në kalendar, RASH-i përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë në format shkresor dhe elektronik, me informacionet si më poshtë:

- a) IAL-ja;
- b) njësia kryesore e IAL-së;
- c) cikli i studimit;
- d) programi i studimit;
- e) data e regjistrimit;
- f) ID-ja e maturës;
- g) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

8. Kandidati, i cili ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

#### I. PROCESI I ÇREGJISTRIMIT, RAUNDI I DYTË

1. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistrin e IAL-së, ka të drejtë të çregjistrohet në datat e përcaktuara në kalendar. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda këtij afati, ai nuk ka të drejtë të çregjistrohet me qëllim regjistrimin në një program tjetër studimi ku është shpallur fitues për atë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin *U-Albania* nga sekretaria mësimore e fakultetit.

2. Sekretaritë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të kandidatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin *U-Albania* listën e kandidatëve të çregjistruar në format elektronik, sipas përcaktimeve në kalendar.

#### J. PROCEDURA E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PAS PËRFUNDIMIT TË RAUNDIT TË DYTË

1. Pas përfundimit të raundit të dytë, IAL-të, brenda 5 ditëve, përcaktojnë me vendim të Senatit Akademik programet e studimit që nuk aktivizohen



në atë vit akademik për shkak se nuk plotësojnë numrin minimal të studentëve të regjistruar për aktivizimin e programit, sipas parashikimeve në aktet e brendshme të IAL-ve. Vendimi i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin, QSHA-së dhe studentëve të regjistruar në këto programe, afishohet në mjediset e tyre dhe publikohet në faqen e tyre zyrtare. Sekretaritetë mësimore kryejnë çregjistrimin e këtyre studentëve në datën e përcaktuar në kalendar.

2. Kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit *U-Albania* që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, mbi bazën e notës mesatare, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, mbi kriterin e notës mesatare dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga IAL-të, sipas afatit të përcaktuar në kalendar.

3. Sipas afatit të përcaktuar në kalendar, RASH-i përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare në format shkresor dhe elektronik me informacionet si më poshtë:

- a) IAL-ja;
- b) njësia kryesore e IAL-së;
- c) cikli i studimit;
- d) programi i studimit;
- e) data e regjistrimit;
- f) ID-ja e maturës;
- g) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

4. Kandidatët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për atë vit akademik.

### KREU III

#### DOKUMENTACIONI PËR REGJISTRIM

1. Kandidatët fitues duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Pas marrjes së dokumentacionit dhe regjistrimit të kandidatit, sekretaria mësimore e IAL-së bën regjistrimin *online* në portalin *U-Albania*. Kandidatët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kopje e dokumentit të identifikimit;

b) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së maturës shtetërore/dëftesës së pjekurisë ose të një diplome studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar nga QSHA-ja, së bashku me certifikatën përkatëse të notave;

c) deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga kandidati në prani të punonjësit të sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet prej tyre.

d) formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 2, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Sekretaritetë mësimore mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të kandidatit kryhet regjistrimi *online* në portalin *U-Albania*. Në fund të procedurës, kandidati dhe punonjësi i sekretarisë mësimore firmosin në dy kopje formularin e printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet kandidatit.

### KREU IV

#### PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Kandidati që kërkon të ndjekë studimet në një program të dytë studimi apo të transferojë studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ka të drejtë të aplikojë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të përcaktuara në kalendar.

2. Kandidati aplikon në IAL për program të dytë studimi apo transferim studimesh, deri në 5 (pesë) programe studimi.

3. Kandidati që aplikon për transferim studimesh plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për



vitin përkatës akademik në të cilin është regjistruar në IAL.

4. Nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Kandidati që aplikon për transferim të studimeve apo për program të dytë studimi duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilët aplikon, me përjashtim të nxënësve ose studentëve të shkëlqyer. Kandidati nuk duhet të jetë duke ndjekur një tjetër program studimi.

5. Aplikimi për transferim studimesh mund të bëhet nga një program studimi i licencuar dhe akredituar, i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël, i ndjekur nga kandidati në IAL-të vendase apo të huaja. Në këtë kuadër nuk mund të kryhen transferime studimesh ndërmjet programet të studimeve dyvjeçare me karakter profesional, programeve të studimeve të ciklit të parë dhe në programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

6. Kandidati, që aplikon për transferim të studimeve, paraqet, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programet përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:

a) formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 3, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi;

c) planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse. Studenti që transferon studimet nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, dorëzon të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njehsuar me origjinalin planin e plotë të programit të studimit përfshirë syllabuset përkatëse, si dhe listën e notave me kreditet e fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer;

d) vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;

e) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së Maturës Shtetërore/dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011;

f) kopje të dokumentit të identifikimit;

g) dy fotografi personale;

h) kopje të mandatpagesës.

7. Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

a) emrin, atësinë, mbiemrin;

b) datëlindjen;

c) vendlindjen;

d) shtetësinë;

e) numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;

f) emrin e institucionit të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë/IAL-së ku ka kryer studimet përpara ndjekjes së këtij programi studimi;

g) ID-në e Maturës Shtetërore /nr. regj. të veçantë<sup>2</sup>;

h) numrin personal të identitetit;

i) datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;

j) emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;

k) ciklin dhe formën e studimit;

l) datën e ndërprerjes së studimeve.

8. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin përkatës të studimeve:

a) formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 3, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi;

c) kopje të njehsuar me origjinalit të diplomës dhe listën e notave/suplementin e diplomës, të studimeve të arsimit të lartë të kryera më parë;

d) vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);

e) kopje të njehsuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme (për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011). Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga

<sup>2</sup> Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006.



drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP përkatëse, si dhe listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

f) kopje të dokumentit të identifikimit;

g) dy fotografi personale.

9. Kandidatët fitues me diplomë të huaj, në këto programe studimi, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, si të gjithë kandidatët e tjerë, por regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, pa pasur domosdoshmëri në momentin e regjistrimit dokumentin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA-ja.

10. IAL-të shpallin në vende të dukshme listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi, brenda datës së përcaktuar në kalendar.

11. Çdo aplikim për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim nga IAL-ja, brenda datës së përcaktuar në kalendar. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit shpallen në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe në faqet *web* përkatëse, e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr. 4, të këtij udhëzimi.

12. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listën me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në kalendar. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të pranimit për programin përkatës të studimit. Lista përmban pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

13. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehën me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

14. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar në kalendar.

15. Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore sipas afatit të përcaktuar në kalendar, në bazë të

dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe në listë, brenda datës së përcaktuar në kalendar.

## KREU V

### PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËVE ME ORIGINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA E VERIUT, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, KANDIDATËVE ME STATUSIN E PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, ME STATUSIN E JETIMIT, SI DHE TË KANDIDATËVE TË PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e pakicës rome dhe egjiptiane, aplikojnë pranë IAL-ve, sipas kalendarit, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-të.

2. Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilët është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri në datën e përcaktuar në kalendar. Në të njëjtën datë, IAL-të shpallin listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, të cilat bëhen publike në mjediset e IAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen në datën/at e përcaktuar/a në kalendar.

3. Aplikimi kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të lartë dhe plotësojnë:

a) kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për vitin përkatës akademik, me përjashtim të kategorive të përjashtuara në këtë vendim;





b) kriteret shitesë të pranimit të vendosura nga IAL-të për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.

5. Kandidatët, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilës aplikon.

6. Aplikimi dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njësisë kryesore të IAL-ve.

7. Sekretaritetë mësimore mbajnë regjistrë për aplikimet e depozituara. Me depozitim e aplikimit, njësitë kryesore përllëgarisin mesataren për çdo kandidat, në përputhje me përcaktimet në vendimin e Këshillit të Ministrave për vitin e ri akademik. Kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen nga sekretaritetë mësimore për ndërprerjen e aplikimit.

8. Kandidatët në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dorëzojnë:

i. formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;

ii. deklaratën sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;

iii. kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton njohjen e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, shoqëruar me kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA-së për njohje dhe njehsim të diplomës;

iv. kopje të njehsuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë dhe të përkthyer në gjuhën shqipe (nëse është lëshuar në gjuhë të huaj) të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet;

v. dokument identifikimi;

vi. dy fotografi;

vii. kopje të mandatpagesës.

b) Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e pakicës rome dhe egjiptiane, dorëzojnë:

i. formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;

ii. kopje të diplomës/dëftesës, të shoqëruar me listën e notave;

iii. në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi, si dhe kopje të njehsuar me origjinalin, të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njehsuar me origjinalin të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme;

iv. kopje të dokumentit të identifikimit;

v. dy fotografi personale;

vi. kopje të mandatpagesës;

c) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuara, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij kreu, duhet të dorëzojë kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) ose kopje të njehsuar me origjinalin të librezës përkatëse të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

d) kandidati me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij kreu, duhet të dorëzojë edhe kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

e) kandidati që i përket pakicave rome apo egjiptiane, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojë edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton përkatësinë në pakicën rome apo egjiptiane.

9. Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë kre. Por, regjistrimi si student i këtyre kandidatëve fitues mund të bëhet me rezervë, nëse në momentin e regjistrimit nuk zotërojnë dokumentin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA-ja.

10. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të



përcaktuara nga ana e tyre dhe publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes për çdo program studimi që ofrojnë. Gjithashtu, IAL-të, në datën e përcaktuar në kalendar, publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

11. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehen me vendim të argumentuar, lidhur me ankimin, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

12. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar në kalendar, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

13. Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar në kalendar.

14. Pas datës së përcaktuar në kalendar, sekretariteti mësimorë në njësitë kryesore të IAL-ve, për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

15. IAL-të, brenda datës së përcaktuar në kalendar, përfundojnë regjistrimin e kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.

## KREU VI

### PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE ME DIPLOMË TË HUAJ TË SHKOLLËS SË MESME NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Të gjithë kandidatët me diplomë të huaj të arsimit të mesëm të lartë, që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të

parë, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të përcaktuara nga IAL-të, për çdo vit akademik, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat për këto kategori nga IAL-të në programet e studimit që ato ofrojnë.

2. Kandidatët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga IAL-të, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

3. Kandidatët i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë kre. Regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, nëse në momentin e regjistrimit nuk zotërojnë dokumentin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA-ja.

4. Kandidatët, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilës aplikojnë.

5. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.

6. Kandidatët duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;

b) kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton njohjen e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, shoqëruar me kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA-së për njohje dhe njehsim;

c) kopjen e dokumentit të identifikimit;

d) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe). Kandidatët që kanë kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar



një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë;

e) dy fotografi personale;

f) kopjen e mandatpagesës;

g) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Kandidatët paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-së përkatëse. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm.

8. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i studimit të IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i paraqitjes së dëshmisë së njohjes së kësaj gjuhe të huaj.

9. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të publikojnë në mjedisë të dukshme dhe në faqen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehen me vendim të argumentuar, lidhur me ankimin, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

11. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Kandidatët regjistrohen vetëm në një nga programet e studimit ku janë shpallur fitues, brenda datës së përcaktuar nga IAL-ja. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për t'u regjistruar në një program tjetër studimi.

13. Sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët e renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të

regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

14. Sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjister të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjister, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

## KREU VII

### PRANIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE”

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë, me përjashtim të programeve të integruara të ciklit të dytë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, për çdo vit akademik të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore, në IAL, në datat e përcaktuara në kalendar.

2. IAL-të shpallin publikisht kriteret e pranimit, hapjen e procedurave të aplikimit, afatet e konkurrimit dhe të regjistrimit, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si dhe informacione të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecures normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-ve.

3. Brenda afateve, IAL-të afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësisë kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (*web*) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga kandidatët, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara.

4. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

5. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve, sipas kalendarit.

6. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon edhe në faqen e saj elektronike zyrtare



(*neb*), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datave përkatëse të përcaktuara në kalendar.

7. Njësitë kryesore të IAL-ve organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve”, sipas kuotave respektive të pranimit realizohet në bazë të përzgjedhjes, në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kriterëve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

9. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit, dhe akredituar para diplomimit të studentit, ose;

b) janë diplomuar jashtë vendit në një institucion të arsimit të lartë ose institucion tjetër të autorizuar të huaj, të akredituar, për një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njohjen dhe njehsimin e diplomës pranë QSHA-së, sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

10. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, ose kopje të saj të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me kopje të diplomës të njehsuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njohja dhe njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit të diplomës, paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA-së për njohje dhe njehsim;

b) formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 2, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;

c) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;

d) kopjen e dokumentit të identifikimit;

e) dy fotografi personale;

f) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse, vetëm për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë;

g) kandidatët e kategorive të veçanta, përveç dokumenteve të kërkuara më sipër, dorëzojnë:

i. kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuara duhet të dorëzojë dhe kopjen e njehsuar me origjinalin të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAP-së;

ii. kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe kopjen e njehsuar me origjinalin të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

11. Kandidati i pakicës rome apo egjiptiane, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që i përket kësaj pakice.

12. Pranë departamenteve të njëjve kryesore të IAL-ve ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve, sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

13. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët, sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit.

14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja, pas verifikimit, i



bën me dije IAL-ve mbi mospajisjen me numër matrikullimi dhe i kërkon çregjistrimin e studentit.

#### KREU VIII

#### PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE OSE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Kandidatët që kërkojnë të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve apo të ndjekin një program të dytë studimi, me përjashtim të programeve të integruara të studimit, aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara në kalendar.

2. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për transferim studimesh apo për program të dytë studimi kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 (pesë) programe studimi përpara fillimit të vitit akademik.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh në programet e ciklit të dytë të gjithë kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë të studimeve, si dhe ndjekin një program studimi të ciklit të dytë në momentin e transferimit;

b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë të studimeve, si dhe ndjekin një program studimi të ciklit të dytë në momentin e transferimit. Kandidati është i detyruar të kryejë njohjen dhe njehsimin e diplomës pranë QSHA-së, brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Transferimi i studimeve në ciklin e dytë të studimeve mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël, sipas kriterëve të vendosura dhe të shpallura publikisht, paraprakisht nga IAL-ja.

5. Transferimi i studimeve kryhet në zbatim të procedurave të përcaktuara sipas afateve të parashikuara në kalendar.

6. Aplikojnë në programet e ciklit të dytë për program të dytë studimi, kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë të studimit, i cili rezulton i licencuar në

momentin e regjistrimit dhe i akredituar para diplomimit të studentit; ose

b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të dytë të studimit. Kandidati është i detyruar të kryejë njohjen dhe njehsimin e diplomës pranë QSHA-së, brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

7. Kandidati që aplikon për transferim në ciklin e dytë të studimeve paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij në IAL dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës ose kopje të saj të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve. Diploma e ciklit të parë e fituar jashtë vendit shoqërohet me aktin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA-ja ose kopje të tij të njehsuar me origjinalin;

b) diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose kopje të tyre të njehsuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, ‘Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike’, i ndryshuar”, paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinal ose kopje të njehsuar me origjinalin, të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku kanë përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;

c) formularin i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 3, të këtij udhëzimi;

d) kopjen e dokumentit të identifikimit;

e) dy fotografi personale;

f) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që



provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

g) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi;

h) dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga i cili transferohet, që përmban:

i. emrin, atësinë, mbiemrin;

ii. datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë;

iii. numrat e matrikullimit të programit të studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë dhe fakulteteve përkatëse të IAL-së ku ka përfunduar studimet dhe nga ku transferohet;

iv. emërtimin e IAL-së dhe të programit të studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë dhe forma e studimit;

v. datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet;

i) planin e plotë të programit të studimit nga ku transferohet, vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera.

8. Kandidati, që aplikon për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve, paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij në IAL dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, ose kopje të njehsuar me origjinalin, të ciklit të dytë të studimeve. Diploma e ciklit të dytë e fituar jashtë vendit shoqërohet me aktin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA-ja ose kopje të tij të njehsuar me origjinalin, brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim;

b) diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës ose kopje të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve. Diploma e ciklit të parë e fituar jashtë vendit shoqërohet me aktin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA-ja ose kopje të tij të njehsuar me origjinalin;

c) diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose kopje të tyre të njehsuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që

kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, ‘Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike’, i ndryshuar”, paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinal ose kopje të njehsuar me origjinalin, të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku kanë përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;

d) formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 3, të këtij udhëzimi;

e) kopjen e dokumentit të identifikimit;

f) dy fotografi personale;

g) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar ose arsim të mesëm të lartë, ose një program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë;

h) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi;

i) planin e plotë të programit të ciklit të dytë të studimeve përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetimin e listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.

9. Kandidatët e kategorive të veçanta për transferim në ciklin e dytë të studimeve ose për program të dytë në ciklin e dytë, paraqesin dokumentacionin shtesë, si më poshtë:

a) kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuara duhet të dorëzojë edhe kopjen e njehsuar me origjinalin të librezës përkatëse të lëshuar nga



Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAP-së;

b) kandidati me statusin e jetimit duhet të dorëzojë dhe kopjen e njehsuar me origjinalin të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

c) kandidati që i përket pakicës rome apo egjiptiane, dorëzon edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që i përket kësaj pakice.

10. Pranë departamenteve të fakulteteve të IAL-ve ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës së atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet, kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave të pranimit për secilin program.

11. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi zhvillohet pranë IAL-së përkatëse, në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në kalendar. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

12. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja, pas verifikimit, i bën me dije IAL-së mbi mospajisjen me numër matrikullimi dhe i kërkon IAL-së çregjistrimin e studentit.

13. IAL-të shpallin publikisht kriteret e pranimit, hapjen e procedurave të aplikimit, afatet e konkurrimit (në rast se ka) dhe të regjistrimit, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe çdo njoftim tjetër të nevojshëm, për sigurimin e ecursë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së.

14. Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të dhëna shpallen në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse (*web*), të plotësuara sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr. 5, të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për

kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.

15. IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar në kalendar.

16. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në kalendar. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrin ligjor në fuqi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, i cili shpallet në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse (*web*), të plotësuara sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr. 5, të këtij udhëzimi.

17. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat paraprake me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në kalendar. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

18. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 (tri) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar, lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

19. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar në kalendar.

20. Regjistrimi i kandidatit, i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore sipas periudhës së përcaktuar në kalendar. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe, brenda datës së përcaktuar në kalendar.

## KREU IX

### PRANIMET NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE “MASTER EKZEKUTIV”

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv”, bëhen pranë sekretarive



mësimore të njësisë kryesore, në IAL, sipas afateve të përcaktuara në kalendar.

2. Brenda afateve të përcaktuara në kalendar, IAL-të shpallin dhe afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësisë kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (*web*) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga kandidatët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

3. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 (tri) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehen me vendim të argumentuar, lidhur me ankimin, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve, sipas afateve të përcaktuara në kalendar.

5. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (*web*), listën emërore të kandidatëve të regjistruar sipas afateve të përcaktuara në kalendar.

6. Njësitë kryesore të IAL-ve organizojnë procesin e pranimi, të regjistrimit të kandidatëve dhe verifikojnë dokumentacionin e pranimi sipas kuadrit ligjor në fuqi.

7. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të tretë, “Master ekzekutiv”, sipas kuotave respektive të pranimi, realizohet në bazë të përzgjedhjes në bazë të akteve, kuadrit ligjor në fuqi, si dhe kritereve të përcaktuara nga njësitë bazë dhe të bëra publike paraprakisht.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv”, kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit; ose

b) janë diplomuar jashtë vendit në një institucion të arsimit të lartë ose institucion tjetër të autorizuar të huaj, të akredituar, për një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”, i licencuar dhe i akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njehsimin dhe njohjen e

diplomës pranë QSHA-së, brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

9. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, ose kopje të saj të njehsuar me origjinalin, të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”/ “Master i arteve” të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”/“Master i arteve” të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me kopje të diplomës të njehsuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve të arsimit të lartë të ciklit të tretë në vendin përkatës;

b) vërtetimin për njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, përmes testeve të njohura ndërkombëtare, sipas nivelit të përcaktuar me aktin nënligjor të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

c) formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;

d) kopjen e dokumentit të identifikimit;

e) dy fotografi personale;

f) curriculum vitae;

g) kopje e njehsuar me origjinalin të librezës së punës.

h) për shtetasit e huaj dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse, i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë;

i) deklaratën sipas, shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi.

10. Kandidatët e kategorive të veçanta për aplikimin për program studimi të ciklit të tretë





“Master ekzekutiv”, paraqesin dokumentacionin shtesë, si më poshtë:

a) kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuara, dorëzon edhe kopjen e noterizuar të librezës përkatëse të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të KMCAP-së;

b) kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe kopjen e njehsuar me origjinalin të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

c) kandidati që i përket pakicës rome apo egjiptiane, dorëzon edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që i përket kësaj pakice.

11. Pranë departamenteve të njëjve kryesore të IAL-ve ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës së kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kriteret e deklaruara paraprakisht nga IAL-ja për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse.

12. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët, sipas afateve të parashikuara në kalendar. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

13. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja, pas verifikimit, i bën me dije IAL-të mbi mospajisjen me numër matrikullimi.

14. IAL-të shpallin publikisht kriteret e pranimi, hapjen e procedurave të aplikimit, afatet e konkurimit (në rast se ka) dhe të regjistrimit, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe çdo njoftim tjetër të nevojshëm, për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së.

#### KREU X DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

1. IAL-të dorëzojnë listat e studentëve në QSHA, përfshirë edhe ata të regjistruar me rezervë,

në formë shkresore dhe elektronike, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit, sipas afateve të mëposhtme:

a) brenda datës 30 nëntor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve;

b) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve;

c) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të studentëve që i përkasin pakicës rome dhe egjiptiane në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve;

d) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve me diplomë të huaj, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve;

e) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë të studimeve, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve”;

f) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e ciklit të dytë të studimeve;

g) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve, “Master ekzekutiv”.

2. Për kandidatët e regjistruar me rezervë në një program studimi të arsimit të lartë, të cilët kanë detyrim njohjen dhe njehsimin e diplomës



përkatëse, IAL-të përcjellin në QSHA, brenda datës 30 prill të çdo viti akademik, dokumentet e njohjes dhe njehsimit të diplomave të tyre, të lëshuara nga QSHA-ja. QSHA-ja e pajis me numër matrikulli përpara fillimit të sezonit të dytë të provimeve.

3. Për të gjithë kandidatët e përcjellë pas afateve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij kreu, ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, QSHA-ja nuk do të procedojë me dhënien e numrave të matrikullimit. Në këto raste, QSHA-ja njofton IAL-në, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, dhe i kërkon çregjistrimin e kandidatit. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i QSHA-së, IAL-ja njofton kandidatin për arsyet e mosmatrikullimit dhe kryen çregjistrimin e tij, si dhe njofton me shkresë zyrtare, brenda 7 (shtatë) ditëve QSHA-në për çregjistrimin e tij.

4. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme, kandidati duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga QSHA-ja dhe dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga institucioni i arsimit të mesëm të lartë dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

5. Kandidatët e shpallur fitues në programet e të gjitha cikleve të studimit nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të, në të njëjtin vit akademik, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

6. IAL-të përpilojnë një raport të hollësishëm, në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe

formatet e kërkuara sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin, që përcakton elementet përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë. Ky raport dërgohet në MAS, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti akademik.

7. Përjashtimisht, urdhri i përbashkët i QSHA-së dhe RASH-it, për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023–2024, miratohet në muajin korrik 2023.

8. Udhëzimi nr. 10, datë 15.5.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar për miratimin e kalendarit, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, për çdo vit akademik, si dhe publikimit të tij brenda muajit qershor të çdo viti kalendarik.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Evis Kushi**

SHTOJCA NR. 1

#### DEKLARATË

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, (emri atësia mbiemri) lindur më \_\_\_\_\_ me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë \_\_\_\_\_ ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve të arsimit të lartë në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre. Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve, lidhur me: studimet e arsimit të lartë, ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë,  
Faqe | 10834



dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe/ose institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe/ose IAL-ja nisën procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

\_\_\_\_\_  
Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma:

Vendi: \_\_\_\_\_

SHTOJCA NR. 2

Data: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

### **Formular aplikimi**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësi mbiemri  
me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_, tel: \_\_\_\_\_

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit: (të shënohet me “x” përzgjedhja e kandidatit)

- ☐ Me karakter profesional (1- ose 2-vjeçar)
- ☐ Bachelor
- ☐ Integruar i ciklit të dytë “Master i shkencave”
- ☐ Master profesional
- ☐ Master i shkencave/Master i arteve
- ☐ Master ekzekutiv

\_\_\_\_\_ në LAL \_\_\_\_\_.

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët:

a) shtetas shqiptarë brenda vendit;

b) me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

- ☐ Republika e Kosovës;
- ☐ Mal i Zi;
- ☐ Maqedonia e Veriut;
- ☐ Preshevë;
- ☐ Bujanovci;
- ☐ Medvegja;



c) me diplomë të huaj

Me shtetësi: \_\_\_\_\_

Gjuhë amtare: \_\_\_\_\_

Me arsim të mesëm: \_\_\_\_\_

Adresë aktuale: \_\_\_\_\_

2. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (të shënohet me “x” kategoria):

☐ PAK;

☐ jetim;

☐ pakica Rome;

☐ pakica Egjiptiane.

3. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituar dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale, në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve të arsimit të lartë, në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

4. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallëm fitues për vitin akademik në vijim.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

7. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma

SHTOJCA NR. 3

Data \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

### **Formular aplikimi për transferim studimesh ose program të dytë studimi**

Unë i/e nënshtetësi/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_

emri, atësia, mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_, tel: \_\_\_\_\_

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit (vendosni një rreth):

☐ me karakter profesional 2-vjeçar;

☐ ciklit të parë “Bachelor”;

☐ integruar të ciklit të dytë;

☐ ciklit të dytë “Master profesional”;

☐ ciklit të dytë “Master i shkencave”/ “Master i artëve”;

në \_\_\_\_\_, në LAL \_\_\_\_\_

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

A. Për program të dytë studimi

B. Për transferim studimesh

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët:



a) shtetas shqiptarë brenda vendit;

b) me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

☐ Republika e Kosovës;

☐ Mal i Zi;

☐ Maqedonia e Veriut;

☐ Preshevë;

☐ Bujanovci;

☐ Medvegja;

b) me diplomë të huaj:

Me shtetësi: \_\_\_\_\_

Gjuhë amtare: \_\_\_\_\_

Me arsim të mesëm: \_\_\_\_\_

Adresë aktuale: \_\_\_\_\_

2. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (të shënohet me “x” kategoria):

☐ PAK;

☐ jetim;

☐ pakica Rome;

☐ pakica Egjiptiane.

3. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin për pranimet në ciklin përkatës të studimit.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të LAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale, në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

6. Autorizoj, gjithashtu, institucionin e arsimit të lartë dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve, lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

7. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

8. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventalisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma

Emër, atësi, mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma



## SHTOJCA NR. 4

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

| Emër | Atësi | Mbiemër | Datëlindje | Emërtimi i programit të studimit të kryer më parë dhe lloji ("Bachelor", PICD) | IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit | Data e diplomimit në programin e parë të studimit | Emërtimi i programit të studimit ku aplikon për program të dytë dhe lloji ("Bachelor", PICD) | Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati | Kreditet e njohura | Pikët e akorduara | Statusi i kandidatit<br>Ftitues/Jo ftitues |
|------|-------|---------|------------|--------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|--------------------|-------------------|--------------------------------------------|
|      |       |         |            |                                                                                |                                                      |                                                   |                                                                                              |                                                   |                    |                   |                                            |
|      |       |         |            |                                                                                |                                                      |                                                   |                                                                                              |                                                   |                    |                   |                                            |
|      |       |         |            |                                                                                |                                                      |                                                   |                                                                                              |                                                   |                    |                   |                                            |
| 1    |       |         |            |                                                                                |                                                      |                                                   |                                                                                              |                                                   |                    | Kriteri 1         | Pikët totale                               |
| 2    |       |         |            |                                                                                |                                                      |                                                   |                                                                                              |                                                   |                    | Kriteri 2         | ....                                       |
| 3    |       |         |            |                                                                                |                                                      |                                                   |                                                                                              |                                                   |                    |                   |                                            |
| .... |       |         |            |                                                                                |                                                      |                                                   |                                                                                              |                                                   |                    |                   |                                            |



*Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.*

[illegible]



SHTOJCA NR. 5

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

| nr.  | Emër | Atësi | Mbiemër | Datëlindje | Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji | LAL-ja nga transferohet | Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik parardhës | Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati | Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji | Viti i studimit ku transferohet | Kreditet e njohura | Pikët e akorduara | Statusi i kandidatit<br>Fitues/Jo fitues |           |      |              |
|------|------|-------|---------|------------|------------------------------------------------------------------------|-------------------------|-------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|--------------------|-------------------|------------------------------------------|-----------|------|--------------|
| 1    |      |       |         |            |                                                                        |                         |                                                       |                                               |                                                                        |                                 |                    |                   | Kriteri I                                | Kriteri 2 | .... | Pikët totale |
| 2    |      |       |         |            |                                                                        |                         |                                                       |                                               |                                                                        |                                 |                    |                   |                                          |           |      |              |
| 3    |      |       |         |            |                                                                        |                         |                                                       |                                               |                                                                        |                                 |                    |                   |                                          |           |      |              |
| .... |      |       |         |            |                                                                        |                         |                                                       |                                               |                                                                        |                                 |                    |                   |                                          |           |      |              |





Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

| nr.  | Emër | Atësi | Mbiemër | Datëlindje | Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) të kryer më parë dhe lloji | IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit | Data e diplomimit në programin e parë të studimit | Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) ku aplikon për program të dytë dhe lloji | Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati | Kreditet e njohura | Pikët e akorduara |           |      |              | Statusi i kandidatit<br>Fines/Jo fines |
|------|------|-------|---------|------------|------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|--------------------|-------------------|-----------|------|--------------|----------------------------------------|
| 1    |      |       |         |            |                                                                        |                                                      |                                                   |                                                                                      |                                                   |                    | Kriteri 1         | Kriteri 2 | .... | Pikët totale |                                        |
| 2    |      |       |         |            |                                                                        |                                                      |                                                   |                                                                                      |                                                   |                    |                   |           |      |              |                                        |
| .... |      |       |         |            |                                                                        |                                                      |                                                   |                                                                                      |                                                   |                    |                   |           |      |              |                                        |



**UDHËZIM**  
**Nr. 90, datë 27.6.2023**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË**  
**SHËRBIMEVE QË U OFROHEN**  
**SUBJEKTEVE PUBLIKE NGA**  
**SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SHA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të

ndryshuar, si dhe të pikës 7, të vendimit nr. 177, datë 4.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë ‘Illyrian Guard’ sh.a., dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

**UDHËZOJNË:**

1. Institucionet shtetërore dhe shoqëritë aksionare me kapital shtetëror të buxhetojnë tarifat e shërbimeve në fushën e sigurisë, si më poshtë:

| TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SHOQËRISË “ILLYRIAN GUARD” SHA PËR SUBJEKTET PUBLIKE |                                                                            |                                              |
|------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
| SHËRBIM SIGURIE 1.3.A                                                        |                                                                            |                                              |
| I                                                                            | SHËRBIM RUAJTJEJE ME PUNONJËS SHËRBIMI SIGURIE                             |                                              |
|                                                                              | <i>Mënyra e shërbimit</i>                                                  | <i>Tarifë/punonjës në muaj (lek pa TVSH)</i> |
| 1                                                                            | Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (tre turne)                           | 87,892                                       |
| 2                                                                            | Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (turn i parë)                         | 76,014                                       |
| 3                                                                            | Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (turn i parë dhe i dytë)              | 78,337                                       |
| 4                                                                            | Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (turn i dytë)                         | 80,662                                       |
| 5                                                                            | Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (turn i tretë)                        | 106,999                                      |
| II                                                                           | SHËRBIM REAGIMI ME GRUP VERIFIKIMI SINJALESH                               |                                              |
|                                                                              | <i>Shërbim</i>                                                             | <i>Tarifë/muaj (lek pa TVSH)</i>             |
|                                                                              | Shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh                               | 11,322                                       |
| III                                                                          | SHËRBIM RUAJTJEJE ME SISTEME ELEKTRONIKE                                   |                                              |
|                                                                              | <i>Shërbim</i>                                                             | <i>Tarifë/shërbim në muaj (lek pa TVSH)</i>  |
| 1                                                                            | Shërbim sigurie me kamera teke dhe alarm                                   | 37,561                                       |
| 2                                                                            | Shërbim sigurie me NVR deri në 4 kanale dhe alarm                          | 88,701                                       |
| 3                                                                            | Shërbim sigurie me NVR 8-16 kanale dhe alarm                               | 148,400                                      |
| 4                                                                            | Shërbim sigurie me tra parkimi                                             | 19,650                                       |
| 5                                                                            | Shërbim sigurie me akses kontroll me bravë elektrike                       | 3,626                                        |
| 6                                                                            | Shërbim sigurie me akses kontroll <i>face dedection</i> me bravë elektrike | 4,993                                        |
| 7                                                                            | Shërbim sigurie me vëzhgim, alarm, tra dhe akses kontrolli                 | 159,870                                      |
| 8                                                                            | Shërbim sigurie me alarm                                                   | 11,756                                       |
| SHËRBIM SIGURIE 1.3.B                                                        |                                                                            |                                              |
| IV                                                                           | SHËRBIM SIGURIMI DHE SHOQËRIMI I VLERAVE MONETARE E SENDeve TË ÇMUARA      |                                              |
|                                                                              | <i>Shërbim</i>                                                             | <i>Tarifë/ditë për lëvizje (lek pa TVSH)</i> |
| 1                                                                            | Kategoria A - lëvizje urbane                                               | 3,368                                        |
| 2                                                                            | Kategoria A - lëvizje interurbane                                          | 4,398                                        |
| 3                                                                            | Kategoria B - lëvizje urbane                                               | 4,128                                        |
| 4                                                                            | Kategoria B - lëvizje interurbane                                          | 5,158                                        |
| 5                                                                            | Kategoria C - lëvizje urbane                                               | 8,192                                        |
| 6                                                                            | Kategoria C - lëvizje interurbane                                          | 11,282                                       |
| 7                                                                            | Kategoria D - lëvizje urbane                                               | 8,786                                        |



|    |                                   |        |
|----|-----------------------------------|--------|
| 8  | kategoria D - lëvizje interurbane | 11,876 |
| 9  | Kategoria E - lëvizje urbane      | 9,709  |
| 10 | kategoria E - lëvizje interurbane | 12,799 |
| 11 | Kategoria F - lëvizje urbane      | 10,303 |
| 12 | Kategoria F - lëvizje interurbane | 13,393 |

2. Institucionet shtetërore dhe shoqëritë aksionare me kapital shtetëror, në rast nevojë, të buxhetojnë tarifën e shërbimeve për transport personalitetesh me automjete të “Illyrian Guard”, si më poshtë:

| TRANSPORT ME SUV 2. NAFTE                                                      |                              |
|--------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|
| Kostoja                                                                        | Kostoja/ditë përdorimi (lek) |
| Qira dite/makine                                                               | 4,000                        |
| Kosto shoferi/ditë                                                             | 2,917                        |
| Kosto karburanti bazuar në çmim burse (13 litra/100 km) çmim 144.39 lekë/litër | 1,877                        |
| <b>Nëntotal</b>                                                                | <b>8794</b>                  |
| Shpenzime administrative për përgjegjësin + punonjësin e shoqërimit fizik      | 1,975                        |
| Shpenzime administrative për shefin e VIP                                      | 1,284                        |
|                                                                                | <b>12,053</b>                |
| Kosto administrative 3%                                                        | 361                          |
| Fitimi 20%                                                                     | 2,482                        |
| <b>Tarifë ditore</b>                                                           | <b>14,896</b>                |

| TRANSPORT ME ACCENT 1.4 BENZINË                                                |                              |
|--------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|
| Kostoja                                                                        | Kostoja/ditë përdorimi (lek) |
| Qira dite/makine                                                               | 3,000                        |
| Kosto shoferi/ditë                                                             | 2,917                        |
| Kosto karburanti bazuar në çmim burse (11 litra/100 km) çmimi 136.7 lekë/litër | 1,504                        |
| <b>Nëntotal</b>                                                                | <b>7,421</b>                 |
| Shpenzime administrative për përgjegjësin + punonjësin e shoqërimit fizik      | 1,975                        |
| Shpenzime administrative për shefin e VIP                                      | 1,284                        |
|                                                                                | <b>10,680</b>                |
| Kosto administrative 3%                                                        | 320                          |
| Fitimi 20%                                                                     | 2,228                        |
| <b>Tarifë ditore</b>                                                           | <b>13,228</b>                |

| TRANSPORT ME ACCENT 1.6 NAFTE                                             |                              |
|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------|
| Kostoja                                                                   | Kostoja/ditë përdorimi (lek) |
| Qira dite/makine                                                          | 3200                         |
| Kosto shoferi/dite                                                        | 2917                         |
| Kosto karburanti bazuar në çmim burse (9 litra/100 km) 144.39 lekë/litër  | 1300                         |
| <b>Nëntotal</b>                                                           | <b>7417</b>                  |
| Shpenzime administrative për përgjegjësin + punonjësin e shoqërimit fizik | 1975                         |
| Shpenzime administrative për Shefin e VIP                                 | 1,284                        |



|                         |               |
|-------------------------|---------------|
|                         | <b>10676</b>  |
| Kosto administrative 3% | 320           |
| Fitimi 20%              | 2199          |
| <b>Tarifë ditore</b>    | <b>13,195</b> |

| TRANSPORT ME HYUNDAI I20 1.2 BENZINË                                          |                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|
| <b>Kostoja</b>                                                                | <b>Kostoja/ditë përdorimi (lek)</b> |
| Qira dite/makine                                                              | 2800                                |
| Kosto shoferi/dite                                                            | 2917                                |
| Kosto karburanti bazuar në çmim burse (8 litra/100 km) çmimi 136.7 lekë/litër | 1094                                |
| <b>Nëntotal</b>                                                               | <b>6811</b>                         |
| Shpenzime administrative për përgjegjësin + punonjësin e shoqërimit fizik     | 1975                                |
| Shpenzime administrative për shëfën e VIP-së                                  | 1284                                |
|                                                                               | <b>10070</b>                        |
| Kosto administrative 3%                                                       | 302                                 |
| Fitimi 20%                                                                    | 2074                                |
| <b>Tarifë ditore</b>                                                          | <b>12446</b>                        |

3. Institucionet për përzgjedhjen e shërbimit që do të kërkojnë nga shoqëria “Illyrian Guard” sh.a., të bazohen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Shoqëria “Illyrian Guard” sh.a. për zbatimin e këtij udhëzimi.

5. Udhëzimi i përbashkët nr. 407/1, datë 14.6.2019, i ministrit të Financave dhe i ministrit të Brendshëm, “Për mënyrën e përllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shoqëria ‘Illyrian Guard’ sh.a.”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM  
**Bledar Çuçi**

MINISTËR I FINANCIVE  
DHE EKONOMISË  
**Delina Ibrahimaj**

#### ANEKS NR.1

### SHËRBIME TË SHOQËRISË “ILLYRIAN GUARD” SHA

#### 1. Sigurimi fizik me punonjës shërbimi sigurie

Ky shërbim ofrohet sipas nënkategorive të mëposhtme, bazuar në kërkesat dhe aktivitetin e subjekteve të cilët paraqesin nevojën për shërbimin e sigurimit fizik me punonjës shërbimi sigurie, si më poshtë:

| Mënyra e shërbimit |                    | Koeficienti |
|--------------------|--------------------|-------------|
| E hënë–e premte    | Një turn (8 ore)   | <b>1,18</b> |
|                    | 1.5 turne (12 ore) | <b>1,77</b> |
|                    | Dy turne (16 ore)  | <b>2,36</b> |
|                    | Tre turne (24 ore) | <b>3,54</b> |
| E hënë–e premte    | Një turn (8 ore)   | <b>1,42</b> |
|                    | 1.5 turne (12 ore) | <b>2,13</b> |
|                    | Dy turne (16 ore)  | <b>2,84</b> |
|                    | Tre turne (24 ore) | <b>4,26</b> |
| E hënë–e premte    | Një turn (8 ore)   | <b>1,66</b> |
|                    | 1.5 turne (12 ore) | <b>2,49</b> |
|                    | Dy turne (16 ore)  | <b>3,32</b> |
|                    | Tre turne (24 ore) | <b>4,98</b> |



## 2. Shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh

Ky shërbim ofrohet për institucione të cilat kanë investuar në vendosje të sistemeve të vëzhgimit dhe të alarmit me fonde të tyre.

Shërbimi nga shoqëria “Illyrian Guard” sh.a. konsiston në:

- Monitorim 24/7 nga Qendra e Kontrollit;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike.

## 3. Sigurimi ruajtje fizike me sisteme elektronike

### 3.1 Shërbimi i ruajtjes fizike me kamera teke dhe alarm

Shërbimi nga shoqëria “Illyrian Guard” sh.a. konsiston në:

- Vendosje paneli alarmi në objekt;
- Vendosje e 1 kamerë të jashtme;
- Monitorim 24/7 i alarmit dhe kamerës;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike.

### 3.2 Shërbimi i ruajtjes fizike me vëzhgim (NVR 0-4 kanale) dhe alarm

Shërbimi konsiston në:

- Vendosje paneli alarmi në objekt;
- Vendosje e një sistemi vëzhgimi të përbërë nga NVR 0-4 kanale dhe kamera të brendshme/jashtme (1-4 kamera)
- Monitorim 24/7 i alarmit dhe kamerave;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike.

### 3.3 Shërbimi i ruajtjes fizike me vëzhgim (NVR 8-16 kanale) dhe alarm

Shërbimi konsiston në:

- Vendosje paneli alarmi në objekt;
- Vendosje e një sistemi vëzhgimi të përbërë nga NVR 8-16 kanale dhe kamera të brendshme/jashtme (8-16 kamera);
- Monitorim 24/7 i alarmit dhe kamerave;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;
- Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar.

### 3.4 Shërbimi i ruajtjes fizike me barriera elektronike

Shërbimi konsiston në:

- Vendosje akses kontrolli dhe barriere elektronike (tra parkimi, tripod, piston ose tip tjetër barriere elektronike);
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;

- Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar;
- Karta akses.

### 3.5 Shërbimi i ruajtjes fizike me akses kontrolli me bravë elektrike

Shërbimi konsiston në:

- Vendosje akses kontrolli;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;
- Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar;
- Karta akses.

### 3.6 Shërbimi i ruajtjes fizike me akses kontrolli *face dedection* me bravë elektrike

Shërbimi konsiston në:

- Vendosje akses kontrolli me opsion të njohjes së fytyrës;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;
- Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar;
- Karta akses.

### 3.7 Shërbimi i ruajtjes fizike me vëzhgim, alarm, tra dhe akses kontrolli

Shërbimi konsiston në:

- a) Vendosje e një sistemi vëzhgimi të përbërë nga NVR 5-16 kanale dhe kamera të brendshme/jashtme (5-16 kamera);
- b) Vendosje akses kontrolli;
- c) Vendosje e një sistemi alarmi;
- d) Vendosje barriere elektronike (tra parkimi, tripod, piston ose tip tjetër barriere elektronike);
- e) Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;
- f) Monitorim në kohë reale 24/7 përmes Qendrës së Kontrollit;
- g) Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar;
- h) Karta akses.

### 3.8 Shërbimi i ruajtjes fizike me vëzhgim, alarm, tra dhe akses kontrolli

Shërbimi konsiston në:

- a) Vendosje e një sistemi alarmi;
- b) Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;
- c) Monitorim në kohë reale 24/7 përmes Qendrës së Kontrollit;
- d) Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar.

## 4. Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e të sendeve të çmuara gjatë transportit



**4.1 Kategoria A: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë deri në 10.000.000 lekë**

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë);

b) Jo më pak se dy punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve i certifikuar për drejtues mjeti);

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së;

d) Sistem gjurmimi GPS;

e) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

f) Kamera për lexim automatik të targave.

**4.2 Kategoria B: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 10.000.000 lekë deri në 25.000.000 lekë**

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave monetare nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë);

b) Jo më pak se tre punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve i certifikuar për drejtues mjeti);

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së;

d) Sistem gjurmimi GPS;

e) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

f) Kamera për lexim automatik të targave.

**4.3 Kategoria C: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 25.000.000 lekë deri në 75.000.000 lekë:**

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave monetare nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-4;

b) Jo më pak se katër punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve i certifikuar për drejtues mjeti);

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së;

d) Sistem gjurmimi GPS;

e) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

f) Kamera për lexim automatik të targave;

g) Dy automjete të blinduara, përkatësisht njëri para dhe tjetri pas automjetit të blinduar ku janë vendosur vlerat monetare.

**4.4 Kategoria D: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 75.000.000 lekë deri në 150.000.000 lekë**

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave monetare nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-5;

b) Dy automjete të blinduara BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë) për transportimin e punonjësve të SHPSF-së;

c) Jo më pak se pesë punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4, (dy prej të cilëve të certifikuar për drejtues mjeti);

d) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së dhe ndërmjet mjeteve të eskortës;

e) Sistem gjurmimi GPS;

f) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

g) Kamera për lexim automatik të targave

**4.5 Kategoria E: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 150.000.000 lekë deri 550.000.000 lekë**

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-6;

b) Dy automjete të blinduara BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë), për transportimin e punonjësve të SHPSF-së;

c) Jo më pak se gjashtë punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B 4 (dy prej të cilëve të certifikuar për drejtues mjeti);

d) Sistem të bllokimit motorik të automjetit që transporton vlera monetare;



e) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së dhe ndërmjet mjeteve të eskortës;

f) Sinjali i njoftimit SOS;

g) Sistem gjurmimi GPS;

h) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

i) Kamera për lexim automatik të targave.

**4.6 Kategoria F: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 550.000.000 lekë – 950.000.000 lekë:**

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet me pjesë të ndarë të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-7;

b) Dy automjete të blinduara BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë) për transportimin e punonjësve të SHPSF-së;

c) Jo më pak se shtatë punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (tre prej të cilëve të certifikuar për drejtues mjeti);

d) Sistem të bllokimit motorik të automjetit që transporton vlera monetare;

e) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së dhe ndërmjet mjeteve të eskortës;

f) Sinjali i njoftimit SOS;

g) Sistem gjurmimi GPS;

h) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

i) Kamera për lexim automatik të targave

**4.7 Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë mbi shumën 950.000.000 lekë**

Transportimi i vlerave monetare mbi shumën 950.000.000 lekë, përveç masave të parashikuara në kategorinë F, pikat “a” dhe “b”, nga shërbimi privat i sigurisë fizike, strukturat e Policisë së Shtetit në territorin e të cilit do të lëvizë eskorta, planifikojnë dhe marrin masa shtesë sigurie, sipas përcaktimit të bërë nga legjislacioni në fuqi.

## KËRKESË

Shtetasja Fatbardha Lami, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Agim Lami, i lindur më 4.7.1957, në Mazrek, Tiranë, me atësi Rexhep dhe amësi Pashe.

KËRKUESE  
**Fatbardha Lami**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|                 |
|-----------------|
| Formati 61x86/8 |
|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë